EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5714
E premte, 1 mars 2019
çmimi 0.40 €

Blerim Reka shpall kandidaturën për president të Maqedonisë Veriore

FAQE 2

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ZYRTARËT E LARTË AMERIKANË GJATË VIZITËS NË PRISHTINË KANË TAKUAR EKIPIN NEGOCIATOR TË KOSOVËS DHE DISA DEPUTETË TË PARTIVE OPOZITARE FAQE 4-5

SHBA-ja RRIT PRESIONIN PËR HEQJEN E TAKSËS, KOSOVA PA QENDRIM TË BASHKUAR

Zyrtarët e lartë të Këshillit për Siguri Kombëtare të ShBA-së kanë takuar të enjten anëtarët e delegacionit negociator të Kosovës dhe disa deputetë të opozitës duke ua prezantuar edhe një herë këshillën e tyre për pezullimin e taksës për mallrat serbe dhe vazhdimin e dialogut me Serbinë. Presidenti Hashim Thaçi, lideri i LDK-së, Isa Mustafa, dhe disa anëtarë të ekipit negociator kanë bërë thirrje që të respektohet këshilla amerikane.

Sugjerimet amerikane për suspendim të taksës nuk e kanë bindur kryeministrin Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se për shkak të paqartësive të procesit Kosova e ka të vështirë ta pezullojë taksën

KUVENDI MIRATON PROJEKTLIGJIN PËR MËSIMDHËNËSIT E VITEVE '90-'99 FAQE 3

Me 71 vota për deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar në lexim të dytë Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës 1990/99. Votimi i këtij projektligji është mirëpritur nga ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqyri Bytyqi, i cili ka thënë se kjo është më e pakta që mund të bëhet për mësimdhënësit

Limaj: Rezultatet e mira të vendit kanë pasur kontributin e Nismës FAQE 5

AKTUALE

DYFYTYRËSIA ANTOLOGJIKE DHE BIZANTINIZMI I CERTIFIKUAR I RADIKALIT ALEKSANDAR VUÇIQ F. 10

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

PREJ SOT PROKURORËT ME KOD TË RI TË ETIKËS F. 7

FSK-ja MBAN LIGJËRATA RRETH VETËDIJESIMIT TË NXËNËSVE NGA RREZIKU I MJETEVE TË PASHPËRTHYERA F. 7

EKONOMI

BRENDA 60 DITËSH FILLOJNË PUNIMET NË AUTOSTRADËN KIJEVË - ZAHAQ F. 9

MINISTRI SHALA, NË MBËSHTETJE TË INDUSTRISË SË NDËRTIMIT F. 8

SPORT

ALIU: MË MBETET MERAK MOSPARAQITJA NDAJ PRISHTINËS F. 15

KOSOVA SËRISH E MPOSHTI BULLGARINË F. 15

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht – Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Blerim Reka shpall kandidaturën për president të Maqedonisë së Veriut

Profesori i së drejtës ndërkombëtare dhe ish-ambasadori i Maqedonisë në Bruksel, Blerim Reka, duke njoftuar se ka shpallur kandidaturën për president të Maqedonisë së Veriut, ka thënë se vetëm me kandidatët maqedonas, pa asnjë shqiptar, kjo shoqëri shumetnike rrezikon të rrëshqasë drejt shtetit monoetnik, e shqiptarët vetëm votues, por jo edhe të votuar

Shkup, 28 shkurt - Profesori i së drejtës ndërkombëtare dhe ish-ambasadori i Maqedonisë në Bruksel, Blerim Reka, ka shpallur kandidaturën për president të Maqedonisë së Veriut. Reka në llogarinë e vet në "Facebook" ka bërë me dije se në zgjedhjet presidenciale do të garojë si kandidat i pavarur. "Në pamundësi t'u përgjigjem të gjitha medieve dhe miqve, përmes këtij njoftimi e bëj publike kandidaturën time të pavarur për president të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me shpresë se do të përkrahet". "Janë dy arsye për këtë vendim. E para: vetëm me kandidatët maqedonas, pa asnjë shqiptar, kjo shoqëri shumetnike rrezikon të rrëshqasë drejt shtetit monoetnik, e shqiptarët vetëm votues, por jo edhe të votuar. E dyta: vetëm kritikat intelektuale - pa i hyrë përballjes politike - nuk mjaftojnë për ndryshimin e gjendjes. Ato në FB mbeten virtuale, ndërkaq jeta është, megjithatë, reale. Fundja, historinë e shkruajnë shtetarët, intelektualët vetëm shkruajnë për historinë", ka shkruar Reka. Opozita shqiptare do ta mbështesë ish-ambasadorin Blerim Reka si kandidat i pavarur për president të Maqedonisë së Veriut. Reka, i cili ka njoftuar për shpalljen e kandidaturës së tij, do ta ketë mbështetjen e Lëvizjes Besa dhe Aleancës për Shqiptarët (ASh) për grumbullimin e nënshkrimeve të nevojshme për kandidaturë.

Lideri i ASh-së, Ziadin Sela, ka thënë se marrëveshja me opozitën ka për qëllim që shqiptarët të mos i bëjnë thjesht votues, por vendimmarrës. Partnerët e koalicionit qeveritar LSDM dhe BDI janë duke e mbajtur të fshehur emrin e kandidatit të përbashkët për të cilin të mërkurën në mbrëmje janë pajtuar Zoran Zaevi dhe Ali Ahmeti.

Meta takohet me kryeministrin e Egjiptit

Tiranë, 28 shkurt - Në kuadër të vizitës zyrtare në Egjipt, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, u prit në takim të veçantë nga kryeministri i Republikës Arabe të Egjiptit, Mostafa Kemal Madbouly.

Presidenti Meta shprehu kënaqësinë e veçantë për vizitën në Egjipt, duke e quajtur dëshmi të vullnetit të përbashkët për një fillim të ri në marrëdhëniet midis dy vendeve.

Presidenti Meta dhe kryeministri Madbouly ndanë të njëjtin mendim lidhur me nevojën e mbledhjes së Komisionit të Përbashkët në një kohë sa më të afërt, si dhe për përfundimin e marrëveshjeve që do ta pasurojnë kuadrin ligjor dhe do të ndihmojnë në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ekonomik dhe kulturor.

Presidenti Meta nënvizoi nevojën e bashkëpunimit në fushën e energjisë, të turizmit e të transportit ajror e detar. Gjatë këtij takimi, presidenti Meta e siguroi kryeministrin Madbouly se, falë pozicionit gjeografik, Shqipëria mund të bëhet një portë hyrëse e sipërmarrjeve egjiptiane për rajonin e Ballkanit.

Nga ana e tij kryeministri Madbouly vlerësoi mundësinë e bashkëpunimit mes autoriteteve portuale si dhe u shpreh se të dy vendet mund të bëjnë shumë për forcimin e rolit të tyre në rajonet respektive. Gjatë takimit u biseduan edhe mbi zhvillimet në rajonin e Ballkanit Perëndimor si dhe për nevojën e rritjes së bashkëpunimit për adresimin e sfidave të përbashkëta në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Basha: Protesta dhe mosbindje civile në turin tonë të shpresës

Tiranë, 28 shkurt -"Ne do t'i gërshetojmë protestat me mosbindjen civile dhe të gjithë aktet e tjera të revoltës dhe zemërimit qytetar kundër një bande që ka marrë peng Shqipërinë, në turin tonë të shpresës", deklaroi kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, në një prononcim për mediet pas takimit me strukturat e PD-së në Shkodër.

I pyetur për qëndrimin e eurodeputetëve se djegia e mandateve të opozitës është rruga e gabuar dhe se parlamenti është legjitim, Basha tha se nuk komenton deklaratat e miqve të huaj. "Jam në Shkodër, qytetit që i ka prirë rrugëtimit prej tri dekadash të Shqipërisë drejt Evropës. Ky është një rrugëtim i mbushur me sakrifica, por i dhimbshëm, por rrugëtimi i vetëm që do ta çojë Shqipërinë drejt shpëtimit, drejt çlirimit të saj nga e keqja që e ka kapur për fyti. Rruga drejt Evropës është e vetmja që do ta çojë drejt shpëtimit, drejt dinjitetit. Në këtë rrugëtim është radha jonë të bëjmë këtë sakrificë sepse ne qëndrojmë dhe luftojmë për vlerat e Evropës. Ne e bëjmë sepse kjo sakrificë është e domosdoshme për të zhbllokuar rrugën drejt Evropës nga pengesat që i janë vënë asaj në veçanti në këto pesë vite. Rrugën drejt Evropës e pengojnë krimi dhe korrupsioni, hajdutëria qeveritare dhe ortakllëku me krimin e organizuar. Të gjithë në Shqipëri e dinë dhe të gjithë në botë po e dëgjojnë. Tani është koha të shpalosim të vërtetën që për një kohë kaq të gjatë janë helmuar nga propaganda e Edi Ramës. Nuk shkohet në Europë me gënjeshtra, në Europë shkohet

me vlera dhe vlera kryesore e Evropës është demokracia dhe sakrifica e opozitës është rikthimi i demokracisë duke mos qenë fasadë parlament i krimit", tha Basha.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kuvendi miraton Projektligjin për mësimdhënësit e viteve '90-'99

Me 71 vota për deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar në lexim të dytë Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës 1990/99. Votimi i këtij projektligji është mirëpritur nga ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqyri Bytyqi, i cili ka thënë se kjo është më e pakta që mund të bëhet për mësimdhënësit

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 SHKURT - Deputetët e Kuvendit të Kosovës në vazhdimin e seancës plenare kanë votuar të enjten në lexim të dytë Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës 1990/99. Në favor të këtij projektligji kanë votuar 71 deputetë të Kuvendit të Kosovës. Pas votimit të këtij projektligji, ka reaguar ministri i Arsimit, i Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi. Ai i ka uruar mësimdhënësit e viteve 1990/99, duke thënë se kjo është më e pakta që mund të bëhet për mësimdhënësit tanë. "Urime të gjithë mësimdhënësve të viteve 1990/99! Projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës 1990/99 sapo u miratua në Kuvendin e Kosovës. Ky është kurorëzimi i shumë përpjekjeve që kemi bërë për këtë ligj dhe kjo më bën të lumtur pafund. Kjo është më e pakta që mund të bëjmë për mësimdhënësit tanë, të cilët janë heronjtë e atyre viteve më të vështira për Kosovën. Do të bëjmë edhe shumë më shumë, sepse mësimdhënësit janë, po ashtu, heronjtë e të sotmes dhe të ardhmes sonë!", ka shkruar Bytyqi në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e cila është zëvendëskryetare e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, Teuta Haxhiu, ka uruar mësimdhënësit e viteve '90 për miratimin e këtij projektligji. Ajo ka thënë se Kuvendi i Kosovës ka pesë vjet që ka pritur miratimin e këtij ligj. "Urime Ligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99! Kuvendi votoi këtë ligj të cilin e pritëm mbi pesë vjet që Qeveria të sjellë në Kuvend, duke u obliguar nga Komisioni Parlamentar për arsim që në muajin prill 2013. Këtë kërkesë e kuptoj seriozisht Qeveria Haradinaj, duke planifikuar edhe buxhetin në 2019-s. Urime mësimdhënës të dashur!", ka shkruar Haxhiu në llogarinë e vet në "Facebook".

Ne seancën e së enjtes, për shkak të mosarritjes së votave të mjaftueshme, do të përsëritet votimi për anëtarët e propozuar për kryesues të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE). Po në këtë seancë plenare, në mungesë të votave, nuk është hedhur në votim në lexim të dytë Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete si dhe shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka thënë se është për keqardhje mosmiratimi i Ligjit për automjete nga ana e deputetëve të Kuvendit. "Për keqardhje që as kësaj radhe nuk kaloi Ligji për automjetet. Sot në Kosovë 70 për qind e automjeteve janë më të vjetra se 15 vjet dhe ky ligj kishte veç një qëllim që, sadopak, të përmirësohej mesatarja e vjetërsisë së automjeteve që janë në qarkullim. Nuk po e ndotkan ambientin veç ato që janë më të reja sesa 15 vjet! Është tragjike kur krejt kjo bëhet në emër të mbrojtjes së qytetarit. Nuk kanë faj, se vetë nuk e kanë këtë hall, e sa për popull të cilin e përfaqësojnë, disa deputetëve po duket që nuk u bëhet vonë asnjëherë", ka thënë Nitaj.

Policia konfiskon 10 kilogramë marijuanë dhe arreston pesë persona

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Policia e Kosovës ka arrestuar pesë persona të cilët dyshohet se kanë qenë pjesë e një grupi që kanë kryer veprën penale "blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve".

Gjatë arrestimit, Policia e Kosovës ka konfiskuar më shumë se dhjetë kilogramë substancë narkotike, që dyshohet të jetë e llojit marijuanë. "Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë, pas një pune hetimore në Skenderaj, ka ndaluar tri vetura, gjatë kontrollit të të cilave janë gjetur 20 paketime me substancë që dyshohet të jetë marijuanë, me peshë të përgjithshme prej 10 kilogramësh e 835 gramësh", thuhet në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Policia njofton se ka konfiskuar edhe tri vetura dhe pesë telefona celularë, ndërkohë që të dyshuarave, me aktvendim të prokurorit, u është caktuar masa e ndalimit prej 48 orësh.

Zyrtarët e lartë amerikanë gjatë vizitës në Prishtinë kanë takuar ekipin negociator të Kosovës dhe disa deputetë të partive opo

ShBA-ja rrit presionin për heqjen e ta

Zyrtarët e lartë të Këshillit për Siguri Kombëtare të ShBA-së kanë takuar të enjten anëtarët e delegacionit negociator të Kosovës dhe disa deputetë të opozitës duke ua prezantuar edhe një herë këshillën për pezullimin e taksës për mallrat serbe dhe për vazhdimin e dialogut me Serbinë. Presidenti Hashim Thaçi, lideri i LDK-së, Isa Mustafa dhe disa anëtarë të ekipit negociator kanë bërë thirrje që të respektohet këshilla amerikane. Sugjerimet amerikane për suspendim të taksës nuk e kanë bindur kryeministrin Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se për shkak të paqartësive të procesit, Kosova e ka të vështirë ta pezullojë taksën

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 28 SHKURT - Drejtori kryesor për Çështje Evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të ShBA-së, John Erath, dhe drejtori për Ballkan të Këshillit Kombëtar të Sigurisë së ShBA-së, Brad Berkley, kanë vazhduar të enjten përpjekjen e tyre për t'i bindur zyrtarët e lartë shtetërorë të Kosovës për suspendimin e taksës ndaj mallrave serbe. Ndonëse zyrtarët e lartë amerikanë nuk kanë dhënë ndonjë deklaratë për media pas takimeve me ekipin negociatar dhe disa deputetë të opozitës, këta të fundit kanë treguar për kërkesat amerikane.

Zyra e presidentit përmes një njoftimi për medie ka treguar se për çfarë është biseduar në takimin e zyrtarëve amerikanë me anëtarët e ekipit negociator të Kosovës, përkatësisht me zëvendëskryeministrin Behgjet Pacolli, Fatmir Limaj, Enver Hoxhaj, Dardan Gashi dhe me kryetarin e PSD-së, Shpend Ahmeti. "Në këtë takim është biseduar për procesin e dialogut përfundimtar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për përgatitjet e këtij procesi dhe për tejkalimin e pengesave aktuale, duke përfshirë këshillat e ShBA-së për domosdoshmërinë e suspendimit të përkohshëm të taksës dhe rifillimin e dialogut, si dhe për shtimin e përpjekjeve për arritjen e marrëveshjes gjithëpërfshirëse. Ishte konstatim i përbashkët, se marrëveshja duhet të jetë përfundimtare me njohje reciproke", është thënë në njoftimin e Presidencës, duke shtuar se anëtarët e ekipit negociator janë shprehur të gatshëm për respektimin e këshillës amerikane. "Të gjithë anëtarët e ekipit negociator kanë shprehur shqetësimin për veprimet agresive të Beogradit, në të njëjtën kohë kanë shprehur edhe gatishmërinë e tyre për respektimin e këshillës së ShBA-së për suspendimin e taksës dhe rifillimin e dialogut në Bruksel", është bërë me dije në komunikatën e Presidencës.

Sipas komunikatës, në këtë takim presidenti Thaçi ka ripërsëritur qëndrimin se me asnjë kusht dhe në asnjë rrethanë Republika e Kosovës nuk do t'i rrezikojë marrëdhëniet ndërshtetërore dhe miqësinë speciale me ShBA-në. Pas këtij takimi edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, ka dhënë një porosi për politikanët e vendit tonë. "Martin Luther King Jr. dikur thoshte: 'Koha është gjithmonë e drejtë për të bërë atë që është e drejtë'. Një kujtesë e mirë për politikanët në Kosovë…", ka shkruar Kosnetti në llogarinë vet në "Twitter".

Për kërkesat amerikane kanë folur vetë anëtarët e ekipit negociator të Kosovës.

Bashkëkryesuesi i këtij delegacioni, Fatmir Limaj, ka bërë me dije se zyrtarët e lartë amerikanë edhe një herë kanë paraqitur qëndrimin e tyre për pezullimin e taksës dhe vazhdimin e dialogut. "Përfaqësuesit e lartë të Këshillit Kombëtar të Sigurisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, John Erath dhe Brad Berkley, edhe një herë paraqitën qëndrimin e njohur amerikan për pezullimin e taksës për t'i dhënë mundësi dialogut dhe përkushtimin e ShBA-së për të parë sa më shpejt një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë e cila do ta mbyllte njëherë e përgjithmonë konfliktin mes dy vendeve", ka thënë Limaj.

Limaj shpreson se do të arrihet një zgjidhje për ta vazhduar dialogun duke respektuar këshillën amerikane. "Shfrytëzova rastin për të thënë se vendimi për taksën ka qenë vendim shtetëror dhe tashmë është e qartë se ka këndvështrime të ndryshme rreth kësaj teme. I sigurova që po punojmë fuqishëm që institucionet e Kosovës rreth kësaj çështjeje të kenë një qëndrim unik i cili do t'i mundësonte edhe fillimin e dialogut, duke marrë parasysh këshillat e miqve tanë amerikanë", ka thënë ai.

Edhe bashkëkryesuesi tjetër i delegacionit, Shpend Ahmeti, ka thënë se tashmë qëndrimi i ShBA-së për këtë çështje është i qartë. Ahmeti ka thënë se tash i mbetet Kosovës të vendosë se cili është interesi i saj strategjik.

zitare

ksës, Kosova pa qëndrim të bashkuar

"Unë nuk jam deklaruar për suspendimin as në këto takime dhe as në takimet e tjera. Kemi folur për arsyeshmërinë e taksës dhe pse ka qenë e nevojshme. Qëndrimi i ShBA-së është i qartë. Edhe arsyeja e taksës është e qartë. Tash i mbetet Kosovës të vendosë se cili është interesi strategjik. Çfarëdo veprimi që shihet si fitore personale dhe fitore elektorale e dëmton Kosovën dhe pozicionin negociator të saj", ka deklaruar Ahmeti. Kurse anëtari i këtij ekipi, zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka thënë se Kosova gjithmonë ka dalë fituese kur ka dëgjuar këshillat amerikane. "Në rrugëtimin tonë si shtet, partneriteti i ngushtë me ShBA-në është jetik dhe, si i tillë, do të jetë i pacenueshëm. Vendimi për taksën ka qenë shtetëror, i drejtë dhe legjitim. Qëndrimi ynë do të jetë unik dhe në koordinim të ngushtë me aleatët amerikanë. Kosova gjithmonë ka dalë fituese kur ka pasur në krahë dhe ka dëgjuar këshillat amerikane", ka deklaruar Pacolli.

Haradinaj: E vështirë heqja e taksës, kemi paraqitësi të mëdha

Sugjerimit amerikan për heqjen e taksës nuk po i bindet kryeministri Ramush Haradinaj. Ai në një konferencë për medie të enjten ka thënë se Kosova ka paqartësi të madha për fazën përfundimtare të dialogut. "E kemi shumë të vështirë marrjen e një veprimi për pezullim të taksës për shkak të paqartësive. Ne nuk po e dimë për çfarë është fjala. A është fjala për një proces të dialogut siç e kemi pasur deri më tani, ku ftohemi në takime? E kemi parë se ky proces na ka dëmtuar realisht në vazhdimësi. Apo është fjala për arritjen e një marrëveshje të cilën ne nuk e kemi parë dhe nuk e dimë se çka është. Pra, është bukur zor Kosova të marrë një veprim në terr. Realisht ne nuk e dimë se ku po e qesim këmbën tani", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se edhe ai do ta përkrahte heqjen e taksës nëse do të diheshin të gjitha temat në procesin e dialogut.

Kryeministri Haradinaj ka treguar se më lehtë do të ishte sikur i gjithë spektri politik të ishte unik për mosheqjen e taksës. "Përçarja e madhe po na shkatërron dhe po na ul pozicionin negociues me Serbinë. Po na nxjerr probleme të brendshme. Sikur të kishim qenë bashkë, me qëndrim të njëjtë, që Serbia nuk mund të shesë me zor te ne pa na njohur, jam thellë i bindur se do të kishin një gjendje tjetër në Kosovë. Për fat të keq, nuk është kështu. Mirëpo, mendoj se është më mirë të heqim heq keq tani si Kosovë nëse është nevoja se sa në fund të na vë dikush një kontratë që merr përkrahje ndërkombëtare, por që nuk është në rregull për Kosovën", ka deklaruar Haradinaj.

Mustafa: Si pozita ashtu edhe opozita kanë përgjegjësi për vendin

Për kërkesën amerikane rreth taksës është njoftuar zyrtarisht edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa. Ky i fundit ka treguar se për këtë çështje është informuar nga presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të cilit ia ka shprehur brengosjen e tij dhe të LDK-së për situatën në të cilën koalicioni qeverisës e ka sjellë vendin.
Në profilin e vet në "Facebook", i pari i LDK-së ka shkruar se ka kërkuar nga presidenti të heqë dorë nga orientimi i tij dhe diskursi politik për korrigjim të kufijve, në mënyrë që të krijohet një ambient normal për dialog dhe të evitohet frika nga dialogu. "LDK-ja nuk do të pajtohet në asnjë mënyrë që të dialogohet për territorin, sepse kjo çon në rihapje të shtetësisë. Po ashtu, theksova se është përgjegjësi e koalicionit qeverisës që të gjejë zgjidhje në mënyrë që të ruhet partneriteti me ShBA-në, si aleatin tonë strategjik. Ia shpreha qëndrimet e LDK-së për dialogun dhe nevojën që para dialogut të shkohet në zgjedhje për ta siguruar legjitimitetin", ka shkruar Mustafa, duke shtuar se për interesa të shtetit ai do të bisedojë me çdo kënd.
Dy zyrtarët e lartë amerikanë gjatë së enjtes janë takuar edhe me disa deputetë të LDK-së, PSD-së dhe Alternativës. Asnjë prej këtyre të fundit nuk kanë folur për medie pas takimit.
Zyrtarët e lartë amerikanë nuk janë takuar me deputetë të Lëvizës Vetëvendosje.

Ambasada e ShBA-së: Taksa e minon partneritetin Kosovë - ShBA

Vizita e dy zyrtarëve të lartë amerikanë, zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë Kombëtare për Evropën, John Erath dhe drejtorit për Çështje Evropiane, Brad Berkley, në Kosovë, ka pasur si qëllim të përsëritet kërkesa e ShBA-së për pezullimin e taksës ndaj mallrave serbe dhe të Bosnjës nga ana e Kosovës, si dhe të bëhet thirrje për vazhdimin e dialogut. Kështu është thënë në një deklaratë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, në të cilën theksohet se delegacioni amerikan ka përsëritur mesazhin se taksa "është pengesë ndaj përparimit, e minon partneritetin tonë dhe duhet të pezullohet për ta çuar përpara dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë".
Sipas kësaj deklarate, zyrtarët e lartë amerikanë gjatë vizitës në Kosovë dhe Serbi kanë përforcuar mesazhin e presidentit të ShBA-së, Donald Trump, se "duhet të shfrytëzohet ky moment i veçantë për arritjen e marrëveshjes Kosovë - Serbi dhe se të dyja palët duhet t'i ndërpresin veprimet që e bëjnë të vështirë arritjen e marrëveshjes". ShBA-ja në të dyja kryeqytet, përmes dy zyrtarëve të lartë, ka shprehur shqetësimet e Shtëpisë së Bardhë dhe iu ka bërë thirrje udhëheqësve në Prishtinë dhe Beograd t'i ndërpresin veprimet provokuese si dhe të ndërmarrin hapa konstruktivë për t'u kthyer në tavolinën e bisedimeve. Ata kanë theksuar nevojën e arritjes së një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Limaj: Rezultatet e mira të vendit kanë pasur kontributin e Nismës

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - "Rezultatet e mira të vendit kanë pasur kontributin e Nismës Socialdemokrate", kështu ka deklaruar të enjten, në pesëvjetorin e këtij subjekti politik, lideri i saj Fatmir Limaj. Ai ka thënë se partia që drejton ka kaluar nëpër rrugë të vështira, por që rezultati për këto pesë vjet ka qenë i jashtëzakonshëm. Ai ka kujtuar momentet kur vendosi për themelimin e kësaj partie. "Ishin çaste goxha të vështira, jo të lehta nëpër të cilat kalonte vendi ynë, aspak të favorshme për alternativë të re politike. Vendi kishte nevojë për alternativë të re që kishte qasje të re, me ide të cilat do të kthehen më vonë si urë lidhëse të aktiviteteve në shërbim të vendit. Ne hymë në këtë projekt politik për të përfaqësuar burra dhe gra, djem dhe vajza të cilët ishin të papërfaqësuara", ka thënë Limaj. Ai ka thënë se fryma socialdemokrate është shpërndarë anekënd vendit. "Fryma socialdemokrate sot është e

shpërndarë anembanë Kosovës. Duke ditur se vendi ynë do ballafaqohet me situata të ndryshme, ishte e nevojshme të sjellim njerëz që mendojnë me mendjen e tyre, me gjakftohtësi", është shprehur ai.
Limaj ka theksuar se Nisma Socialdemokrate ka qenë katalizatore e bashkimit të partive opozitare për një opozitë të bashkuar në mbrojtje të interesave të vendit. "Ne kemi filluar aktivitetin politik në kushte të vështira, por për pak muaj arritëm sukses të jashtëzakonshëm. Duke qenë një katalizator i bashkimit të partive opozitare, Nisma dha shpresë pasi për herë të parë në Kosovë u bë një opozitë e bashkuar në mbrojtje të interesave të vendit tonë. Duke u bazuar në këtë rezistencë, partia më e madhe e pasluftës u rrëzua. Ne kemi dalë me disa zotime tona në fushatën elektorale. Më tepër se 12 000 njerëz janë drejtuar në vende punësimi", ka thënë Limaj. Limaj, i cili mban postin e zëvendëskryeministri të Kosovës, ka shtuar se grupi parlamentar i Nismës Socialdemokrate është ndër grupet më të disiplinuara dhe më të rregullta në Kuvendin e Kosovës. Ai ka thënë se Nisma Socialdemokrate edhe komunave do t'u japë shpresë. "Sot kemi plot djem dhe vajza të reja të cilët lënë gjurmë të jashtëzakonshme dhe japin shpresë. Pjesë e madhe që janë në asamblenë komunale do të jenë pjesë edhe e Nismës. Nisma për pesë vjet ka dëshmuar se e ka votuesin dhe elektoratin më të përkushtuar me zemër", ka thënë Limaj. Ai ka folur edhe për qeverisjen në vend, duke treguar për suksesin që ka bërë ky subjekt politik.

Shënohet 21-vjetori i betejës së Likoshanit dhe Qirezit

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 SHKURT - Përfaqësuesit më të lartë shtetërorë dhe komunalë kanë përkujtuar të enjten 21-vjetorin e betejës së Likoshanit dhe Qirezit. Në këtë betejë me forcat serbe, në të cilën ka marrë pjesë edhe komandanti legjendar i UÇK-së, Adem Jashari, kanë renë 24 dëshmorë dhe martirë të familjes Ahmeti, Rexhepi, Behrami, Nebihu, Xheli, Sejdiu, Rama dhe Fazliu.

Duke e kujtuar betejën e Likoshanit dhe Qirezit, presidenti Hashim Thaçi ka thënë se kjo betejë shënon fillimin e largimit të Serbisë nga Kosova. "Në 21-vjetorin e masakrës së Likoshanit dhe Qirezit, i kujtojmë të gjithë martirët dhe dëshmorët e këtyre dy fshatrave të Drenicës. Beteja e UÇK-së te 'Lisi gjashtënjak' me patrullat e policisë serbe ishte fillimi i largimit të shtetit serb nga Kosova. Të nxitur nga humbjet në këtë betejë, makineria policore serbe më pas kishte sulmuar familjet e pafajshme në shtëpitë e tyre. Kosova tashmë kishte hyrë në rrugën e pashmangshme të imponuar të luftës për liri. Por, vetëm sakrifica gjithëpopullore, rezistenca e UÇK-së dhe orientimi kah vlerat civilizuese perëndimore bënë që Kosova ta fitojë përkrahjen e botës demokratike të ShBA-së, BE-së, NATO-s dhe ta fitojë lirinë dhe pavarësinë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se 28 shkurti i vitit 1998 do të mbetet përgjithmonë në kujtesën tonë kombëtare, si dita në të cilën nisi epoka e luftës çlirimtare. "28 shkurti i vitit 1998 do të mbetet përgjithmonë në kujtesën tonë kombëtare si dita në të cilën nisi epoka e luftës çlirimtare. Në zemrat tona i përjetshëm do të qëndrojë kujtimi dhe nderimi për të rënët e asaj dite në Likoshan dhe Qirez", ka shkruar Veseli.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka përkujtuar betejën e Likoshanit dhe Qirezit, duke thënë se kjo betejë paraqet pikënisjen e historisë sonë më të re. "Shteti i pavarur dhe sovran i Kosovës u lind dhe i ka

rrënjët në luftën e lavdishme çlirimtare dhe rezistencën e shumë brezave për të drejtën tonë. Sot, kur kujtojmë me nderim 21-vjetorin e betejës së Likoshanit dhe Qirezit, pikënisje e historisë sonë të re, reflektojmë për rrugëtimin tonë deri në Kosovën e 17 shkurtit 2008. Në thelb të vizionit për të sotmen dhe të ardhmen tonë qëndron si testament flijimi i dëshmorëve dhe martirëve. Lavdi e përjetshme të gjithë të rënëve për lirinë e Kosovës!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë vet në "Facebook".

Për nder të betejës së Likoshanit dhe Qirezit dhe të rënëve në këtë betejë është mbajtur një tubim përkujtimor, në të cilin kanë marrë pjesë zyrtarë të Komunës së Skenderajt dhe Drenasit, përfaqësuesi i familjes Jashari, Rifat Jashari, zyrtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, familjarë, drejtues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe qytetarë të shumtë. Pas këtij tubimi përkujtimor është bërë edhe zbulimi i pllakës përkujtimore për katër vëllezërit e vrarë të familjes Sejdiu, nga bacë Rifat Jashari dhe bacë Sheremet Sejdiu, babai i katër vëllezërve të vrarë.

LB-ja: Moszgjidhja e çështjeve me Serbinë, parajsë e vërtetë për keqqeverisjen e korrupsionin

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Lëvizja për Bashkim (LB) përmes një komunikate për media ka theksuar se bllokimi i dialogut "të vjetër" dhe mundësia e hapjes së një dialogu mbi baza të tjera i ka lënë nën hije të gjitha punët e tjera të qeverisë e të institucioneve shtetërore. "Kjo situatë më së shumti u ka konvenuar e po u konvenon atyre që janë mësuar me krim të organizuar, korrupsion, nepotizëm dhe dukuri të tjera të dëmshme për shtetin e qytetarët", është thënë në komunikatën e LB-së.

Ky subjekt politik që drejtohet Valon Murati ka theksuar se përplasjet publike rreth marrëveshjes me Serbinë kanë lënë në margjina çështje shumë të

rëndësishme e vitale për shtetin e për jetën e qytetarëve. "Në veri të vendit katër kryetarët serbë kanë dhënë dorëheqje dhe shteti me mekanizmat e vet nuk po ka guxim t'i organizojë zgjedhjet e reja, duke krijuar kështu terren për vakum joinstitucional e kaos të vërtetë atje; raportet e shtetit me 'Bechtel Enka' janë jotransparente dhe zakonisht në dëm të Kosovës; kontrata me 'Contour Global' për 'Kosovën e Re' konsiderohet shumë e dëmshme e me pasoja afatgjata për Kosovën; keqmenaxhimi i ndërmarrjeve publike dhe pronës publike si dhe i buxhetit dhe i rezervave të shtetit kalojnë pothuajse në heshtje e të mos flasim se si po shfrytëzohet kjo situatë për punësimet partiake e familjare, me të cilët janë mbushur institucionet e ndërmarrjet publike. Çështje të tilla të cilat prekin interesin e qytetarëve dhe e dëmtojnë jetën e tyre të përditshme ka shumë, ndërsa reagimi i publikut dhe debati publik është shumë i vogël për shkak se krejt vëmendjen e publikut po e zë problematika me Serbinë", është theksuar në këtë komunikatë.

LB-ja ka vlerësuar se stërzgjatja dhe sabotimi i zgjidhjes së problemeve me Serbinë, të përcjella me retorika patriotike e populiste, janë parajsë e vërtetë për keqqeverisjen, krimin e organizuar dhe korrupsionin, por po i kushtojnë e do t'i kushtojnë shumë Kosovës dhe qytetarëve të saj. "Prandaj, të gjitha institucionet shtetërore, të gjitha partitë politike, madje edhe intelektualët dhe shoqëria civile, duhet t'i shtojnë përpjekjet në drejtim të marrëveshjes përfundimtare me Serbinë, si parakusht i kthimit të vëmendjes te cilësia e qeverisjes, ekonomia, sundimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit dhe te jeta më e mirë e qytetarëve", është thënë në komunikatën e LB-së.

Koordinatori Hoti pret në takim drejtorin e ATOMIT

Prishtinë, 28 shkurt (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, i shoqëruar nga zëvendësministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Azem Guri, ka pritur sot në takim drejtorin ekzekutiv të Institutit Ndërkombëtar për Inteligjencë të Jashtëzakonshme (ATOMI), Jusuf Thaçin dhe përfaqësues të organizatës "Debate Centre", Ardi Shatri dhe Njomza Tmava. Në këtë takim u diskutua për garat që tashmë kanë filluar në kuadër të Programi Nacional për Rininë dhe për mundësinë e bashkëpunimit të ndërsjellët. Koordinatori Hoti ka folur për Programin Nacional për Rininë dhe për mundësitë që ky program u jep të gjithë nxënësve dhe studentëve të vendit. Drejtori ekzekutiv i Institutit Ndërkombëtar për Inteligjencë të Jashtëzakonshme (ATOMI), Jusuf Thaçi, ka theksuar se fillimi i realizimit të një programi të tillë është hap i mirë, duke bërë me dije se e mbështet këtë program.

Prej sot prokurorët me kod të ri të etikës

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 SHKURT - Kodi i ri i etikës dhe sjelljes profesionale për prokurorë do të hyjë në fuqi që nga sot (e premte). Ky kod u përpilua nga ekipi i prokurorëve holandezë, në kuadër të projektit "Promovimi i integritetit në sistemin e drejtësisë në Kosovë", që u zbatua nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Lëvizja FOL dhe Qendra Holandeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ligjor (CILC), i mbështetur nga Ambasada e Holandës në Prishtinë.

Ky projekt u përmbyll të mërkurën në një tryeze në të cilën u diskutua mbi të arriturat dhe aktivitetet e tij. Me këtë rast, Aleksandër Lumezi, kryeprokurori i Shtetit, ka shprehur kënaqësinë që projekti i cili u pat iniciuar pas konsultimeve intensive me Ambasadën e Holandës rezultoi me sukses të plotë. "Kemi kodin e ri të etikës për prokurorë, komentarin i cili derivon nga po ky kod dhe modulet për një sërë trajnimesh të dizajnuara nga ekipe të trajnerëve holandezë. Jemi të përkushtuar ta vazhdojmë bashkëpunimin me partnerët tanë të besueshëm në mënyrë që ta avancojmë efikasitetin, efiçiencën si dhe transparencën dhe llogaridhënien", ka thënë ai.

Ambasadorja holandeze Gerrie Willems ka pohuar se të gjithë në këtë sallë duhet ta kenë të qartë se puna jonë nuk përfundon këtu. "Ky është vetëm hapi i parë", ka theksuar ambasadorja Willems, duke shtuar se pjesa më e rëndësishme e punës që i pret në të ardhmen është zbatimi i plotë i reformave të iniciuara. "Vetëm në këtë mënyrë ju do të siguroni qëndrueshmëri të reformave dhe përmirësime konkrete në fushën e integritetit të sistemit të drejtësisë në Kosovë, për të mirën e juaj si prokurorë dhe për të mirën e qytetarëve të Kosovës. Kjo do të ndihmojë në rritjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë", ka thënë ambasadorja holandeze Gerrie Willems.

Ndërkaq drejtori i CILC-së, Willem van Nieuwkerk, ka theksuar rëndësinë e integritetit si në jetën tonë personale ashtu edhe në performancën tonë gjatë karrierës profesionale. "Integriteti kërkon vëmendje të vazhdueshme. Në punën tonë të përditshme përballemi me dilema morale dhe është pikërisht kodi i etikës mekanizmi që siguron kornizën e zgjidhjes së këtyre dilemave. Me këtë projekt kemi sjellë përvojën e Prokurorisë së Holandës dhe bashkë me kolegët tanë kosovarë kemi hartuar kodin e ri të etikës dhe komentarin që ofron shembuj ilustrues nga puna e përditshme e prokurorëve. Shpresojmë se Prokuroria e Shtetit do të përdorë në mënyrë efektive kodin e etikës si mjet që ofron strehë të sigurt dhe mbështetje gjatë punës suaj", ka thënë Van Nieuwkerk.

Kryesuesi i sapozgjedhur i KPK-së, Bahri Hyseni, ka përsëritur zotimin e Lumezit se Prokuroria e Shtetit në Kosovë do t'i mbajë gjithmonë dyert e hapura për partnerët që kanë vullnet të mirë për të ndihmuar në përmirësimin e punës së tyre. "KPK-ja po punon në planin e ri strategjik ku komponenti i ndërtimit të kapaciteteve përmes programeve të ndryshme të trajnimit për prokurorët dhe bashkëpunëtorët e tyre profesionalë përbën pjesën më të madhe të saj", është shprehur Hyseni.

Ky projekt dyvjeçar që ofroi mbështetje teknike dhe ekspertizë për sistemin e drejtësisë u zbatua bashkërisht nga CILC, KDI dhe FOL. Projekti në fjalë ka shënuar përmbylljen zyrtare pas zbatimit me sukses të një sërë aktivitetesh duke filluar nga hulumtimi i plotë i integritetit në sistemin kosovar të drejtësisë, përpilimin e kodit të ri të etikës, komentarin e kodit dhe një sërë trajnimesh mbi etikën, mediat dhe marrëdhëniet me publikun.

FSK-ja mban ligjërata rreth vetëdijesimit të nxënësve nga rreziku i mjeteve të pashpërthyera

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Në disa shkolla fillore të Komunës së Prishtinës, Klinës dhe Malishevës, instruktorë të Kompanisë së Çminimit të FSK-së, edhe këtë vit, që nga 20 shkurti, kanë filluar mbajtjen e ligjëratave rreth vetëdijesimit të nxënësve nga rreziku i mjeteve të pashpërthyera. Këto ligjërata po realizohen në bazë të planit të Departamentit për Bashkëpunim Civil-Ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes me drejtoritë e arsimit të të gjitha komunave të Republikës së Kosovës. Ligjëratat e para për këtë vit u realizuan në Shkollën Fillore "Tre Dëshmorët" në fshatin Jashanicë e Ulët dhe në paralelen e saj në Jashanicë të Lartë, në Komunën e Klinës. Interesimi i nxënësve ishte jashtëzakonisht i lartë për të marrë njohuri për llojet e mjeteve të pashpërthyera, rrezikun nga to, si dhe për veprimin e procedurave standarde në rastet kur hasin në to. Instruktorët e çminimit aktivitetin për vetëdijesimin e nxënësve nga rreziku i mjeteve të pashpërthyera do ta vazhdojnë nëpër shkollat e Republikës së Kosovës deri më 4 mars.

MINISTRI SHALA, NË MBËSHTETJE TË INDUSTRISË SË NDËRTIMIT

Ministri Shala ka ritheksuar se Kosova ka bërë një hap të madh përpara dhe me miratimin e Ligjit për Produktet e Ndërtimit, i cili është miratuar në nëntor të vitit 2018, e që së shpejti do të hyjë në fuqi, do të rregullohen shtyllat e infrastrukturës së cilësisë në fushën e ndërtimit.

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 SHKURT - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, në "Konferencën informuese për legjislacionin e produkteve të ndërtimit", ka theksuar se pas nënshkrimit të marrëveshjes së Stabilizim-Asociim dhe hyrjes në fuqi, janë hapur rrugët që prodhimet e Republikës së Kosovës të plasohen në tregun evropian. "Ne si ministri jemi të përkushtuar që ta rrisim mbështetjen për këtë industri, në hulumtimin dhe njohjen e tregut, në dizajnimin dhe mbështetjen e prodhuesve për certifikimin e produkteve të tyre me skema të veçanta të subvencioneve përmes KIESA-s, në mënyrë që të rritet konkurrenca për t'iu qasur tregjeve të jashtme që ta përmirësojmë bilancin tregtar. Po ashtu, edhe ngritja dhe funksionalizimi i shtyllave të infrastrukturës së cilësisë janë kërkesa të rëndësishme që dalin nga MSA (neni 80), ku Kosova duhet t'i marrë masat e nevojshme në mënyrë që gradualisht ta arrijë përputhshmërinë me legjislacionin e BE-së", u shpreh ministri Shala.

Ai ka bërë me dije se lidhur me këtë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka ndryshuar së fundmi kornizën ligjore për vlerësim të konformitetit, standardizim, akreditim dhe metrologji, njëkohësisht janë duke përafruar legjislacionin sektorial për fushat që janë kompetencë e MTI-së, duke i dhënë fokus edhe implementimit të tij, si dhe duke u angazhuar për ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe të shërbimeve të shtyllave të infrastrukturës së cilësisë.

Ministri Shala ka ritheksuar se Kosova ka bërë një hap të madh përpara dhe me miratimin e Ligjit për Produktet e Ndërtimit, i cili është miratuar në nëntor të vitit 2018, e që së shpejti do të hyjë në fuqi, do të rregullohen shtyllat e infrastrukturës së cilësisë në fushën e ndërtimit.

Shala ka sqaruar se ky ligj është vetëm një pjesë e një procesi më të gjerë të zhvillimit nëpër të cilin duhet të kalojmë dhe që ka gjasa të marrë kohë për të përfunduar plotësisht. "Nëse e zbatojmë siç duhet, ky ligj mund të jetë një udhërrëfyes i rëndësishëm për të na ndihmuar në këtë rrugëtim", ka thënë ministri Shala.

Për dy muaj Trusti 90 milionë euro kthim nga investimet

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës ka njoftuar të enjten se për periudhën janar - shkurt 2019 kthimi bruto nga investimet ka shkuar rreth +90 milionë euro, ose një rritje e çmimit të aksionit prej +5.1 përqindësh. "Me këto ngritje tejet pozitive të këtyre dy muajve të parë të vitit 2019 është kompensuar plotësisht dhe tejkaluar rënia e vlerës së investimeve gjatë tre muajve të fundit të 2018-s. Performanca e investimeve të FKPK-së vazhdon të jetë e bazuar në strategjinë afatgjatë të investimeve, e jetësuar nga Bordi Drejtues i FKPK-së. Përderisa në afat të gjatë kjo strategji është treguar e suksesshme me kthim nga investimet mbi 410 milionë që nga themelimi, duhet theksuar atë që në vazhdimësi e kemi deklaruar, se lëvizjet afatshkurtra (ngritjet e rëniet) në tregjet financiare janë të zakonshme si një proces ciklik dhe, në të ardhmen e afërt, mund të vazhdojnë të ndikohen nga marrëveshja në mes të ShBA-së dhe Kinës, Brexiti si dhe çështjet e tjera gjeopolitike dhe makroekonomike", është thënë në njoftimin e Trustit.

BRENDA 60 DITËSH FILLOJNË PUNIMET NË AUTOSTRADËN KIJEVË - ZAHAQ

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, në një konferencë për medie mbajtur të enjten, ka prezantuar projektin final të autostradës Kijevë - Zahaq nga Njësiti Mbikëqyrës dhe ai i konsulencës nga BERZh-i. Ministti Lekaj ka bërë me dije se ky projekt fillon brenda 60 ditëve dhe do të kushtojë 238 milionë euro

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 SHKURT - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka njoftuar të enjten për përfundimin e projektit final të autostradës Kijevë - Zahaq. Me këtë rast, Lekaj ka thënë se për këtë projekt gjigant të përmbledhur në 240 dosje që përmbajnë të dhënat e detajuara për këtë autostradë, elaboratet shpronësuese dhe lejen mjedisore, brenda dy ditësh do të hapet edhe tenderi për përzgjedhjen e punëkryesit e saj. Me përfundim të procedurave tenderuese, punët në terren për realizimin e autostradës Kijevë - Zahaq, sipas kreut të Infrastrukturës dhe Transportit, pritet të fillojnë brenda dy muajsh. "Brenda dy ditëve do të shpallet tenderi për ofertim dhe brenda 60 ditëve do të fillojnë punët", ka thënë Lekaj.

Kostoja e këtij projekti është rreth 238 milionë euro dhe mjetet për realizimin e saj janë siguruar me kredinë e BERZh-it. Ky projekt është paraparë të përfundojë për 36 muaj, por kjo varet nga plani dinamik që do të paraqesë kompania për kryerjen e punimeve pas përzgjedhjes në procedurat tenderuese.

Punët në autostradën rreth 32 kilometërshe do të kryhen të ndara në tri lote dhe ajo do t'i përmbajë të gjitha paramasat e sigurisë, ndriçimin dhe elementet e tjera të autostradave të niveleve evropiane. Kjo autostradë do t'i lidhë katër komuna: Istogun, Pejën, Gjakovën dhe Klinën.

Detaje rreth këtij projekti ka dhënë edhe sekretari i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, Betim Reçica, i cili është dhe udhëheqës i Njësisë për Zbatim të Projektit. Sa i përket kualitetit të këtij projekti, ai ka pohuar se është e bazuar në standarde evropiane.

MINISTRI REÇICA NËNSHKRUAN MARRËVESHJE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe organizata "World Vision" nënshkruan të enjten marrëveshje bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Marrëveshja që u nënshkrua nga ministri i MPMS-së, Skender Reçica dhe drejtoresha Kombëtare e "World Vision", Eljona Elmazi, ka për qëllim koordinimin e aktiviteteve që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ofrohen për grupet e cenueshme në nevojë, me theks të veçantë personat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët me nevojë për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi.

Ministri Reçica ka falënderuar Elmazin për mbështetjen që organizata po i jep MPMS-së, duke thënë se kjo marrëveshje do të shërbejë për avancim të shërbimeve sa i përket mbrojtjes së fëmijëve, sidomos nga të gjitha format e dhunës si dhe punëve të rënda.

ATK-ja realizoi seminare për tatimpagues

Prishtinë, 28 shkurt (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), me qëllim të informimit të tatimpaguesve për deklarimin vjetor dhe raportimin e pasqyrave financiare, ka realizuar seminare për tatimpagues në të gjitha regjionet e saj, si: Prizren, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Gjakovë, Prishtinë dhe Pejë.

Pjesëmarrësit u njoftuan gjerësisht për deklarimin vjetor dhe raportimin e pasqyrave financiare, të cilat janë prezantuar edhe me shembuj konkretë se si plotësohet deklarata vjetore nga Biznesi Individual (PD), Ortakëria (DO) dhe Personi Juridik (CD).

Gjatë këtyre seminareve, pjesëmarrësit parashtruan pyetje të ndryshme lidhur me temat e prezantuara si dhe pyetje të tjera lidhur me legjislacionin tatimor. Për të gjitha pyetjet e parashtruara nga pjesëmarrësit janë ofruar përgjigje adekuate nga prezantuesit e temave në seminar. Në këto seminare numri i pjesëmarrësve ishte mjaft i lartë, ku pjesëmarrës ishin: organizata biznesi, OJQ apo përfaqësues të tyre, përfaqësues të njësive të përhershme, kontabilistë dhe qytetarë të interesuar.

DYFYTYRËSIA ANTOLOGJIKE DHE BIZANTINIZMI I CERTIFIKUAR I RADIKALIT ALEKSANDAR VUÇIQ

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Vajtimi sikur i një plake të pastrehë: Fillimisht kur Aleksandar Vuçiqi u bë kryetar i Serbisë, duke fituar një simpati edhe nga ndërkombëtarët, krijohej përshtypja se, më në fund, Serbia dhe serbët e kanë një lider sikur që ishte de Goli te francezët dhe se do ta bëjë një prerje të thellë nga e kaluara kriminale e Serbisë, pjesë aktive e së cilës ishte edhe "de Goli" i Serbisë, Aleksandar Vuçiqi.

Natyrisht se retorikën politike e kishte jashtë çdo standardi që e përdornin udhëheqësit e mëparshëm serbë, prandaj u bë i pranueshëm për shumicën e vendimmarrësve në Evropë dhe në ShBA. E kishte një retorikë me një ambalazhim apo mbështjellës demokratik e që mashtroi shumë liderë botërorë, duke ofruar një zgjidhje për Kosovën, me mjete demokratike, duke e përjashtuar dhunën që identifikohej me serbët dhe Serbinë, që nga themelimi i shtetit të Serbisë e deri në ditët e sotme. U bë një lider para të cilit u hapën të gjitha dyert e kancelarive evropiane dhe botërore. Thuaja në të njëjtën kohë shpërtheu dhe shkëlqeu me Edi Ramën duke krijuar përshtypje se janë liderë të ndryshimeve, përkrahës dhe promotorë të demokracisë e që ishte diçka e paparë dhe e padëgjuar deri më tani në Ballkanin e turbulencave kronike. Me një maskë të pështjellur rreth muskujve të fytyrës dukej i përvuajtur dhe sikur ishte i penduar nga krimet e shumta që i bëri Serbia në Kroaci, Bosnje dhe së fundi edhe në Kosovë. Ishte zëdhënës dhe arsyetues i këtyre krimeve sidomos ndaj shqiptarëve, si nxënës shembullor i kriminelit Sheshel. Për çështjen e Kosovës preferonte të bisedonte dhe arrinte një marrëveshje me Edi Ramën i cili, krahasuar me liderët e mëparshëm shqiptarë, shpërtheu me një paternalizëm që aq shumë i kishte munguar shqiptarëve të nëpërkëmbur të Kosovës, Luginës së Preshevës dhe Maqedonisë së Veriut si dhe atyre të Malit të Zi. Qysh atëherë, dyfytyrëshi, rrenci dhe mashtruesi Aleksandar Vuçiq haptas doli për ndryshim të kufijve me deklaratën se: "duhet të fitojë diçka në mënyrë që të kem fytyrë e të dalë para serbëve ...". E ajo diçka ishte territori i Kosovës, në dhunimin e së cilit kishte marrë pjesë aktive. Luante në dy binarë; para BE-së, për shkak të procesit të liberalizimit të vizave deklarohej për demokraci dhe fqinjësi të mirë me Kosovën kurse, nën dhe mbi rrogoz, me të gjitha mjetet e lejuara dhe të palejuara luftonte kundër Kosovës dhe qytetarëve të saj duke instrumentalizuar serbët e Kosovës për qëllime politike përmes frikësimit, shantazheve, ndërprerjes së asistencës ekonomike dhe privilegjeve tjera sikur që ishin rrogat e dyfishta, të Serbisë dhe të Kosovës, me qëllim që t'i shërbejnë Serbisë. Duket se, që prej kohësh, Aleksandar Vuçiqi dhe Edi Rama kanë vepruar si binomë për ndarje të Kosovës, sipas kërkesës së Beogradit. Po ta shikoni fytyrën maskë të Aleksandar Vuçiqit do të krijoni përshtypje se i ngjanë fytyrës së rrahur keq të një pit-bulli ose të një buldogu të ushqyer keq apo të trajtuar dhunshëm.

Apo të një plake të mbetur rrugëve, pa përkrahje dhe mbështetje të askujt, e lënë në mëshirën e kalimtarëve të rastit. Duke mos e zbatuar asnjë marrëveshje të nënshkruar, akuzonte palën kosovare për shpërfillje të marrëveshjeve të arritura dhe të nënshkruara. Aleatë për këtë i kishte armiqtë e Kosovës, mafiozen Federika Mogerini dhe mashtruesi nga Vjena, Johanes Han. E mos të flasim për përfaqësuesit injorantë nga Kosova, të cilëve, më shumë iu interesonte përbërja e menysë ushqimore se temat për të cilat "bisedohej". Dashamirë të kallamarit dhe eksibicionistë të kallakarit!

Kopili politik dhe moral i Nikolla Pashiqit: Kur patrioti i madh kosovar, intelektuali shembullor i njohur për sinqeritet, atdhedashuri, integritet moral dhe politik dhe mbi të gjitha, mbajtës deri në fanatizëm i premtimit të dhënë, Enver Hoxhaj i Gjiro-Rekës propozoi që Serbisë dhe Republika Srpskes t'i futet taksa 100 për qind për mallrat nga këto dy vende fashiste dhe kur kryeministri Haradinaj, me Qeverinë e Kosovës e përkrahën këtë propozim të këtij njeriu të madh, bastardi i Nikolla Pashiqit që rrenën e bëri politikë shtetërore serbe kurse, si standard mbi standardet morale dhe njerëzore e vendosi rrenën, mashtrimin dhe krimin, Aleksandar Vuçiq, gjatë çdo takimi me ndërkombëtarë dhe me qytetarë serbë, me maskën e një pit-bulli të rrahur keq nga rrena dhe mashtrimi deklaronte se taksa prej 100 për qind për mallrat serbe po shkakton krizë humanitare në Serbi sikur që edhe serbët e Kosovës po vdesin nga mungesa e ushqimit dhe barnave për shkak të taksës 100 për qind që ua ka futur Enveri e që i kanë lënë në duar Ramushit. Ndërkombëtarët, të alarmuar nga kjo "katastrofë humanitare" në Serbi dhe për serbët në Kosovë, filluan të bëjnë presion që të hiqet taksa, jo për shkaqe humanitare por për shkaqe politike. Në raste kur duhet të shpërfaqni një vizion për situata të caktuara politike dallohen liderët e vërtetë dhe vendimmarrës që, përkundër risqeve të mëdha propozojnë që të merren vendime të rrezikshme por strategjikisht gjeniale. I tillë është, pa asnjë dyshim Presidenti ynë Legjendar, Hashim Thaçi i cili, i këshilluar nga këshilltarët leg (j)en-darë, me kryelegenin Mekimin, po kërkon largimin e taksës, jo se u dhimben serbët që nuk po kanë as bukë për t'i ushqyer minjtë e as edhe një paracetamoll që do ta ndanin në 28 pjesë por se Vuçiqi nuk i vazhdon bisedimet me Thaçin, pa e larguar taksën! Kërkesë plotësisht e arsyeshme dhe e denjë për ata që kanë problem me kurrizin për shkak të fleksibilitetit të madh apo që e kanë fytyrën si kameleonët, i përshtaten çdo interesi dhe çdo situate. Jemi të njohur si bujarë dhe solidarë, disa e ndjejnë veten si bijë të Nënës Tereze, kurse unë jo, jam bir i Nënës Hamide që shkoi nga kjo botë

Foto:KohaDitore

me mallin tim prandaj nuk na kushton asgjë t'ia miklojmë tope... Aleksandar Vuçiqit, Ivica Daçiqit, Vulinit, Johanes Hanit (nëse i ka), Federikës, Trampit, Boltonit, Sebastian Kuracit dhe miqve të tjerë të Hashimit. Miqve ndërkombëtarë që aq shumë po na duan ...të na shkërdhejnë nënën! Unë, personalisht edhe mund ta shpërfill kërkesën e Presidentit Legjendar për heqjen e taksës, por si ta shpërfillë kërkesën e patriotëve të shquar, që nga koha e Sllobodan Millosheviqit e deri më sot, Ramiz Boro Kelmendit, Gjet Pacovit, Lutë Pirsingut dhe Ton Kuislingut.! Kush jam unë, një hiç hiçi përballë këtyre vlerave të dëshmuara, që nga regjimi demokratik i Millosheviqit e deri te regjimi patriotik i Aleksandar Shim Vuçiqit! Merreni me mend, me taksën 100 për qind po merren Trampi, Boltoni, kongresmenë, Sebastian Kuraci, Hashim Hashimi, Ramiz Boro Kelmendi, Federika Shkeka, Johanes Skllota, Kamish Llulla (nuk është ish-presidenti i Brazilit i arrestuar për hajni prandaj çdo lidhshmëri dhe çdo ngjashmëri është e rastit) Xhavit Nëna e Sigurimeve, Pirsing Luta, zonjat e respektuara të Partisë Demokratike të Kosovës sikur edhe pastruesit e qenefit të Terra Novës. Kamishi dhe Nuredin Ibishi kanë të drejtë edhe zyrtarisht edhe moralisht. Kurse Shkelzen Maliqi dhe Blerim Shala kanë të drejtë, gjenetikisht, familjarisht dhe tradicionalisht. Indianët e Amerikës që u asgjësuan deri në indianin e fundit me moton: "vetëm indiani i vdekur është indian i mirë..", kur donin të arrinin një paqe (gjithmonë mashtroheshin nga keqbërësit), uleshin rreth zjarrit dhe e thithnin Llullen e Paqes. Tash, Kamishi po fton që ta heqim taksën 100 për qind duke e thithur Llullën e Kamishit (Paqes)! Ka të tillë që me dëshirë e bëjnë këtë! Sepse e kanë mënyrë të jetesës dhe mbijetesës, politike dhe fizike! Të poshtër janë, shumë të poshtër janë! Po të sillej Serbia normalisht, jemi shumë të kthyeshëm, nuk do të kishte problem. Por, të gjithë jemi dëshmitarë se Serbia botërisht deklarohet se punon natë e ditë kundër Kosovës kurse nuk sanksionohet me asgjë. Madje, dje kur ishte një presion i hatashëm e unë do e quaja dhunim grupor për heqjen e taksës 100 për qind që i bëhej kryeministrit Haradinaj, çetniku Vuçiq mblodhi në Beograd 140 serbë (ministra, zv.ministra, deputetë, krejt të Kosovës) që marrin rroga, beneficione, shpërdorin vetura zyrtare, gjithashtu të Kosovës të cilët kërkonin përkrahje për t'u larguar nga të gjitha vendet ku "punojnë" në institucionet e Kosovës. Kurse, një mashtrues dhe një kriminel si puna e Vuçiqit i "lutë" të presin edhe 45 ditë, mbase deri t'i afrojnë bizneset me Hashim Hashimin, përmes Kinës, Rusisë, Federika Mogerint, Sebastian Kuracit, dyshes Trap - Bonton.

Merreni pa mend, kryetari i një shteti armiqësorë i thërret 140 zyrtarë të lartë të Kosovës dhe i udhëzon si duhet të punojnë! Për fund iu thotë se asnjë serb nuk duhet të jetë ushtar i FSK-së sikur që të gjithë ata që janë aty duhet të largohen! Ndërkaq, çetniku demokratik, Aleksandar Vuçiqi ka deklaruar se Serbia do të intervenojë ushtarakisht në Kosovë vetëm atëherë kur shqiptarët të fillojnë t'i vrasin serbët. O idiot, kush të beson! Nuk ka asnjë reagim nga "miqtë" ndërkombëtarë dhe miqtë e Hashimit! E tash, këta të na detyrojnë t'i blejmë mallrat e këtyre krimineleve. Jo që nuk duhet t'i blejmë por duhet t'i pshurrim ato sikur edhe ata "biznesmenë" që i importojnë ato e që janë më të zëshmit për heqjen e taksës. Nuk jam Ramush sepse, po të isha Ramush, me këto pamend që i kam, menjëherë e kisha hequr taksën 100 për qind dhe do ta vendosja një kusht tjetër për vazhdim të bisedimeve. Ose duhet të mos ketë kushtëzime për vazhdim të bisedimeve, ashtu ishin menduar bisedimet, ose, nëse i lejohet Serbisë të kushtëzojë, le t'i lejohet edhe Ramushit! Mos të shesin moral, pa - moral, "miqtë" ndërkombëtarë! Lëreni Martin Luter Mbretin të qetë. I kemi edhe ne Adem Jasharin dhe Adem Demaçin që na rrinë mbi ndërgjegjen tonë! Këta janë Kinga - Mbretër të lirisë, ndërgjegjes, mbijetesës dhe vet ekzistencës së shqiptarëve z. Ambasador! Këta na kanë mësuar ta bëjmë gjënë e duhur, në kohën e duhur!

Një porosi miqësore për Hashim Thaçin, Ramush Haradinajn dhe Kadri Veselin: Kohëve të fundit, si shpesh po e përmendni pajtimin me Serbinë kurse kusht e keni kërkimfaljen nga Serbia. Ju nuk merrni erë nga procesi i pajtimit dhe drejtësinë transicionale prandaj po përdorni gjuhë dhe argumente politike. Pajtimi nuk bëhet me vendim politik por pajtimi është domosdoshmëri që do të ndodhë vetëm pasi të përmbushen disa parakushte tjera për të cilat, zotëri të nderuar jeni krejtësisht të painformuar prandaj mos flisni aq lirshëm, si të ishte në pyetje bashkimi - anshllusi i Luginës së Preshevës. Kërkimfalja nuk është si përralla me ujkun që i mashtron qengjat duke e bërë këmbën me miell të bardhë (miell i Devollëve e jo miell i Ramës apo Berishës nga Lazarati) dhe duke u legjitimuar si nëna e tyre! Ka në qeverinë e Kosovës, deputetë të Kuvendit por edhe poste tjera të tillë që ende e konsiderojnë Serbinë si nënë të tyre por kjo nuk duhet të shndërrohet në rregull të përgjithshëm. Figurativisht unë trokitjen në derë e shoh kështu; ai që ka bërë krime mund edhe të trokasë në derë si veprim teknik apo edhe të kërkojë falje, si veprim linguistik. Mirëpo, ai që është brenda e që e ka çelësin e dhomës ku janë me qindra varreza masive, mbi 12,000 të vrarë, me dhjetëra mijëra të plagosur, me një milion të shpërngulur dhunshëm, me një numër të pacaktuar të femrave të dhunuara, me qindra mijëra shtëpi të shkatërruara, me miliarda dollarë të vjedhura të kursimeve, me miliarda të vjedhura të pensioneve, me dhjetëra miliarda dëme materiale, dëme që janë bërë qe 200 vjet ndaj shqiptarëve e që po bëhen edhe sot, ka përgjegjësi nëse do t'i përgjigjet trokitjes në derë, ta hapë derën dhe sa do ta hapë këtë derë. Ai mund të falë sinqerisht kur të vjen koha kurse ju mund të falni politikisht. Ju lutem mos flisni përralla. Këso përrallash i tregonte dikur, menjëherë pas përfundimit të luftës edhe Bernard Kushner Bacës Adem Demaçi, që ishte mbrojtësi më i madh i njerëzve që kishin nevojë për mbrojtje por se Baca nuk besoi në përrallën e ujkut me qengjat prandaj ia përplasi derën në fytyrë Kushnerit pasi ai tha se kushtet e z. Demaçi janë të papranueshme për Serbinë.

Hashimi, pasardhës i denjë i Nënë Terezës: Hashim Thaçi është humanist i madh dhe nuk e kuptoj pse e sulmojnë aq shumë. Me të dëgjuar se Isa Mustafa nuk është mirë me shëndet (po i kruhet prapanica për pushtet), pas takimit me "çunat e Trampit" dhe pasi e pushkatuan Ramushin, nuk shkoi fare në shtëpi por drejt e te Isa Mustafa. Nuk mund të gjeni rast të ngjashëm që dikush, në orë shumë të vona, e lë familjen, për ta vizituar një mik që paska probleme shëndetësore. Po thonë se paska menduar të vizitojë edhe Albin Kurtin por se kundërshtimi i taksës 100 për qind ishte arsye e injorimit të kësaj vizite kurse, sa i përket gjendjes shëndetësore, të gjithë e dinë që Hashim Thaçi 24 orë lutet për shëndetin e Albin Kurtit prandaj nuk ka arsye ta vizitojë! Duhet pranuar se edhe Isa Mustafa është bir i denjë i Nënë Terezës; e fali Albinin dhe po e falë edhe Hashimin. Por jo edhe Adem Demaçin, të cilit, as personalisht, as familjarisht nuk e ngushëlloi kurse partiakisht e bojkotoi, shkaku i një varri dhe një Pablo Eskobari!

Hashim Thaçi nuk ka shkuar te Isa Mustafa me e përcjellë lojën Real - Barcelona (ne, Barcelona nuk po kemi problem me Realin por me Leganes dhe Levanten) por që ta bëjë një koalicion tjetër, koalicion kundër taksës 100 për qind, koalicion të "miqve" të Kosovës dhe koalicion të armiqve të Kosovës. E partner më të mirë dhe më të përshtatshëm se LDK-në për këtë nuk e kanë dhe nuk mund ta gjejnë. Historikisht dhe tradicionalisht, prapanica e LDK-së është e formatizuar dhe e standardizuar për hamshorët e PDK-së. Nuk ka nevojë ndërhyrje të reja, siç thotë ambasadori, për ngulitje të reja. Oferta e LDK-së është automatike sikur që është automatike edhe ngulitja e PDK-së. Pra, mendojeni çiftin e ri, Kamishi and Luta. Përveç dashurisë politike, kanë edhe bazë ligjore në Kushtetutën e Kosovës!

Komuna e Mitrovicës përfiton grant prej 93 681 eurosh nga DEMOS-i

Mitrovicë, 28 shkurt (ER) - Në kuadër të Grantit të Performancës, nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, së bashku me drejtorin e Administratës, Hysen Muzliukaj, kanë nënshkruar marrëveshjen për mirëkuptim dhe financim, ku Komuna e Mitrovicës, falë performancës së saj, është përfituese e një granti në vlerë prej 93 681 eurosh nga projekti i DEMOS-it, i cili është financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim dhe MAPL në kuadër të projektit, i cili ka për qëllim të ofrojë asistencë teknike për komunën me qëllim të përmirësimit të performancës.

Nënkryetari Mujka ka falënderuar DEMOS-in për mbështetjen dhënë Komunës së Mitrovicës, në të njëjtën kohë ai ka shprehur gatishmërinë institucionale për ta rritur performancën komunale në të ardhmen. Ai ka përshëndetur punën e palodhshme të koordinatorit për performancë komunale, Mehmet Bajrami, i cili, së bashku me zyrtarët e tjerë komunalë, me shumë përkushtim po e kryejnë këtë punë. Mjetet e këtij granti do të përdoren për investime kapitale në çfarëdo fushe prioritare në përputhje me kompetencat dhe planet e komunës.

Ndërsa qëllimi i grantit të performancës është stimulimi i komunave për përmirësimin e mëtutjeshëm të performancës së tyre në fushat e qeverisjes demokratike, menaxhimit komunal, transparencës dhe integriteti.

E jashtëzakonshme

I pastrehu bëhet me shtëpi falë një apeli në "Facebook"

I pastrehu gjen shtëpi falë një apeli në rrjetin social "Facebook". Francesko, 63 vjeç, që jetonte rrugëve në Romë për gati 23 vjet, gjeti shtëpi dhe punë në Mantova pas një mesazhi në "Facebook". "Jetoj në rrugë me qenin tim. Jam gati të bëj çfarëdo pune, vetëm më ndihmoni. Di të gatuaj, të pastroj, ta rregulloj kopshtin, bëj muratorin dhe hidraulikun". Ky videomesazh u bë viral dhe mes përgjigjeve të shumta, erdhi edhe ajo e Michael Majderit, titullar i një sipërmarrësi.

FOTO E DITES

Truprojat e Koresë së Veriut ruajnë veturën që transportonte udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong Unin, në qytetin kufitar me Kinën në Dong Dang të Vietnamit. /Reuters/

E rrallë

Amerikanët po shkatërrojnë klimën me letra higjienike

Amerikanët përdorin më shumë letra higjienike se çdokush tjetër në botë. Në këtë mënyrë, kompanitë prodhuese amerikane shkatërrojnë habitatet natyrore dhe që kontribuojnë në ngrohjen globale, ka treguar një studim i ri hulumtues. Konsumatorët amerikanë përdorin përafërsisht tre rrotulla letre higjienike çdo javë, që përbëjnë një të pestën e konsumit të letrës së botës, sipas raportit të titulluar 'Çështja me pëlhurën e hollë: Si amerikanët po i shkatërrojnë pyjet në tualet'.

BARSOLETA E DITËS

- Doktor, doktor vuaj nga amnezia.
- Që kur?
- Që kur, çfarë?!

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Sot ngado që shkoni gjendeni në shoqëri të mirë dhe me miq të këndshëm. Do të ndiheni disi të plogësht gjatë mbrëmjes për shkak të një problemi me shëndetin.

DEMI
Sot do të jenë emocionet tuaja ato që do t'ju drejtojnë në zgjedhjet që do të bëni.

BINJAKËT
Keni mjaft mirëkuptim në familje ku secili bën atë që i takon duke ju lënë kohë të lirë në dispozicion.

GAFORRJA
Jeni disi ëndërrimtar gjatë pjesës së parë të ditës. Shumë shpejt një problem do t'ju kthejë me këmbë në tokë.

LUANI
Sot po e kapni veten shumë herë duke menduar për të shkuarën. Doni të qëndroni vetëm me kujtimet tuaja.

VIRGJËRESHA
Jeni shumë korrekt sot me detyrimet tuaja. Nëse do të kishit një reciprocitet dhe nga personat e tjerë dita do të ishte perfekte.

PESHORJA
Hëna në shenjë sot ju bën romantik më tepër se zakonisht. Shumë mirë paraqitet edhe ana juaj financiare.



AKREPI
Logjika dhe racionaliteti nuk ju mungojnë sot. Kjo do t'ju shërbejë dhe miqve tuaj që shpesh herë janë tepër impulsive.

SHIGJETARI
Sot do të keni një jetë sociale me mjaft angazhime. Autokontrolli shumë herë ju ka privuar nga kënaqësi të vogla.



BRICJAPI
Intuita juaj po ju paralajmëron për një ngërç të vogël në jetën në çift. Mundohuni ta gjeni arsyen pse ka ndodhur.

UJORI
Sot dëshira juaj shkon te kreativiteti gjërat e bukura dhe udhëtimet. Do të keni nevojë për shoqëri të mirë.

PESHQIT
Mjaft harmoni në punë ndërmjet kolegësh. Pak problematik raporti në çift ku dikush kërkon shpjegime.



Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE | CAGLIARI - INTER 2 | LEEDS - WBA GG3+ | AUGSBURG - DORTMUND 2

Aliu: Më mbetet merak mosparaqitja ndaj Prishtinës

Lorik Aliu nuk do ta ketë rastin të jetë në fushë në ndeshjen derbi të Superligës në mes të Llapit dhe Prishtinës. Ai ka thënë për "Epokën e re" se po i mbetet shumë merak mosparaqitja ndaj ish-skuadrës. "Isha i gatshëm dhe maksimalisht i përgatitur, por para një jave në një ndeshje miqësore që zhvilluam kundër Fushë-Kosovës kam pësuar një lëndim në nyje që ndoshta do të më lë jashtë fushës për 3-4 jave. Shpresoj të mos jetë shumë serioz dhe të kthehem në fushë për ta ndihmuar skuadrën drejt arritjes së objektivit. Sinqerisht më mbetet merak se nuk do të kam mundësinë të luaj ndaj ish-skuadrës sime", ka thënë Aliu

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 SHKURT - Mesfushori Lorik Aliu është rikthyer nga lëndimi i gjatë që e kishte mbajtur jashtë fushës së gjelbër për më shumë se katër vjet dhe ka nënshkruar kontratë për dy vjet me skuadrën e Llapit. Nesër (e shtunë) Llapi e pret në stadiumin "Zahir Pajaziti" ish-skuadrën e Lorik Aliut, Prishtinën por, për fat të keq, futbollisti nuk do të ketë mundësi të luajë as në këtë ndeshje për faktin se ka pësuar një lëndim tjetër që nuk është shumë serioz. "Isha i gatshëm dhe maksimalisht i përgatitur, por para një jave në një ndeshje miqësore që zhvilluam kundër Fushë-Kosovës kam pësuar një lëndim në nyje që, ndoshta, do të më lë jashtë fushës për 3-4 jave. Shpresoj të mos jetë shumë serioz dhe të kthehem në fushë për ta ndihmuar skuadrën drejt arritjes së objektivit. Sinqerisht më mbetet merak se nuk do të kam mundësinë të luaj ndaj ish-skuadrës sime", ka thënë Aliu, i cili llogaritej si ndër talentet më të mëdhenj shqiptar, por lëndimet e shpeshta penguan shpërthimi e tij në arenën ndërkombëtare.

Pavarësisht mungesës në këtë ndeshje, Aliu beson se Llapi do të dalë fitues ndaj Prishtinës. Për skuadrën aktuale beson se ka kapacitet që ta ndjekë titullin deri në fund të kampionatit. "Është ende herët, por ne do t'i marrim ndeshjet një nga një dhe gjithmonë hyjmë për fitore. Fillimisht duam ta mposhtim Prishtinës dhe shpresojmë në hapa të tjerë fals të dy skuadrave konkurrente për titull", ka deklaruar ai. Aliu ishte pjesë e Prishtinës në grupmoshën U17 dhe U19 si dhe e Kombëtares së Shqipërisë, kurse ai ishte në prova edhe në skuadrën gjermane Borussia Dortmund ku i bindi drejtuesit e këtij klubi, por për t'u bërë pjesë e kësaj skuadre e penguan lëndimet e njëpasnjëshme.

Sot zhvillohen tri ndeshje në Superligë

Në kuadër të javës së 20 në IPKO Superligën e Kosovës në futboll sot (e premte) zhvillohen tri ndeshje. Ndeshja kryesore do të zhvillohet në Gjilan, ku kampionia aktuale e elitës, Drita, e pret Drenicën. Në dy ndeshjet e tjera takohen: Liria - Gjilani, Ferizaj - Ballkani, derisa Ndërsa të shtunën zhvillohet derbi në mes të Llapit dhe Prishtinës si dhe përballjet KEK-u - Feronikeli dhe Flamurtari - Trepça '89.

SHKURT

Kosova sërish e mposhti Bullgarinë

Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave ka shënuar fitore edhe në ndeshjen e dytë miqësore kundër Bullgarisë (1-4), e cila është zhvilluar në Qendrën Stërvitore "Boyana" në Sofje. Bullgaret shënuan të parat në minutën e tetë, por ky gol i hershëm i vendësve nuk i zmbrapsi futbollistet e Kosovës, të cilat në pjesën e dytë u treguan tejet efikase. Shifrat i barazoi Flaka Asllanaj në minutën e 49, kurse Kosovën në epërsi e kaloi Kaltrina Biçkaj me golin e shënuar në minutën e 60. Për fitoren bindëse të Kosovës u përkujdesen Besiana Reçica dhe Leonora Ejupi, të cilat shënuan nga një gol në minutat 71, përkatësisht 78.

Në fundjavë mbahet turneu "Adem Jashari" në futsall

Më 2 dhe 3 mars do të zhvillohet Turneu Ndërkombëtar Memorial "Adem Jashari" në futsall. Pjesëmarrës në këtë turne do të jenë FC Shkupi, FC Prishtina Futsal, FC Drenica Tradita dhe SEEU Futsal nga Tetova. Të enjten në zyrat e Komisionit të Futsallit është bërë tërheqja e shortit për çiftet gjysmëfinale të këtij turneu. Kësisoj, të shtunën, më 2 mars, në orën 18:30, do të takohen FC Prishtina Futsal - SEEU Tetovë, kurse në orën 20:30 ballafaqohen FC Shkupi - FC Drenica Tradita. Ndërkaq, të dielën, më 3 mars në orën 18:30, zhvillohet ndeshja për vendin e tretë, kurse në orën 20:30 do të luhet finalja e turneut.

Kosovë - Danimarkë zhvillohet më 21 mars

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do ta zhvillojë ndeshjen miqësore ndaj Danimarkës në muajin mars. Në fakt, "Dardanët" në stadiumin "Fadil Vokrri" më 21 mars nga ora 19:00 i presin danezët, kurse kjo është ndeshja miqësore para kualifikuesve në Kampionatin Evropian "Euro 2020". Ndeshjen e parë kualifikuese Kosova, e drejtuar nga Bernard Challandes, e zhvillon ndaj Bullgarisë për Kampionatin Evropian që 'Dardanët' e luajnë më 25 mars.

Shigjetarët përfundojnë garat në Kampionatin Evropian

Ekipi i shigjetarëve të Kosovës ka mbyllur garimin në kampionatin evropian që po mbahet në Samsun të Turqisë. Atdhe Luzhnica dhe Hazir Asllani garuan në kategorinë e seniorëve, ndërsa Drenis Mala e Edi Dvorani në atë të juniorëve. Të gjithë garuan në disiplinën hark olimpik. Atdhe Luzhnica doli i 27-ti me gjithsej 542 rrathë. Në pozitën e 28, nga po aq garues, u radhit Hazir Asllani me gjithsej 541 rrathë. Në rrethin e parë eliminues Luzhnica pësoi humbje 6:0 nga kampioni Olimpik, Victor Ruban nga Ukraina. Me rezultat të njëjtë u mund edhe Hazir Asllani nga Anton Prilepov të Bjellorusisë. Të dy garuesit, Luzhnica dhe Asllani, fituan pikë olimpike "Tokyo 2020". Në kate gorinë e juniorëve, Edi Dvorni pati një paraqitje të suksesshme, duke u renditur në pozitën e 28 me gjithsej 549 rrathë, kurse Drenis Mala u radhit në pozitën e 31-të nga po aq garues, me 530 rrathë. Dvorani kishte paraqitjen më të mirë në evropian dhe në eliminime. Në 1/16, ai pësoi humbje 6:4 nga norvegjezi Sander Thorbjornsen, përkundër që garuesi ynë ishte në epërsi 3:1. Ndërkohë, Drenis Mala u mund 6:0 nga Artem Ovcynnikov i Ukrainës.

"Epoka e re" kërkon fitoren e radhës në Media Ligë

Prishtinë, 28 shkurt - Ndeshjet e javës së 16-të në Media Ligë zhvillohen sot (e premte). Ekipi i gazetës "Epoka e re", që vazhdon të jetë lider, kërkon fitore ndaj "InfoKosova & PrishtinaPost", pasi në ndeshjen e parë kishin mbetur me rezultat 6-6. Ndeshje interesante pritet të zhvillohet edhe në mes të ekipit të dytë në tabelë, "Media Works" dhe "Telegrafi"-it. Punë të lehtë pritet të ketë "Klan Kosova" ndaj "Gazetës Blic", kurse fitore pritet të marrë edhe ekipi në formë të mirë në ndeshjet e fundit, "Infokusi" ndaj "D+". Në ndeshjet e tjera takohen: "Gazeta Zëri"-"Gazeta Metro", "Kosova Press" - "Ora Info", "Kallxo.com" - "RTV Dukagjini", dhe "RTK" - "Lajmi.net".

MKRS-ja, rreth 80 mijë euro për kampionët e xhudos

Trajneri Driton Kuka këtë vit mbështetet në vlerë prej 26 625 eurosh. Ndërsa sportistët u mbështetën veç e veç sipas shumave në vijim: Majlinda Kelmendi me 15 000 euro, Nora Gjakova me 9 000 euro, Distria Krasniqi me 7 500 euro, Loriana Kuka me 6 750 euro, Akil Gjakova me 6 750 euro, Shpat Zeka me 3 750 euro, Erza Muminoviq me 3 000 dhe Laura Fazlia me 1 500 euro

Prishtinë, 28 nëntor - Në bazë të rregullores për kategorizimin e sportistëve dhe trajnerëve, e cila parasheh përkrahjen financiare të tyre, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka nënshkruar të enjten memorandume bashkëpunimi me trajnerin Driton Kuka dhe sportistët Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Distria Krasniqi, Loriana Kuka, Akil Gjakova, Shpat Zeka, Erza Muminoviq dhe Laura Fazlia. Trajneri Kuka, në bazë të memorandumit, mbështetet financiarisht për këtë vit në vlerën prej 26 625 eurosh, me qëllim të realizimit të objektivave dhe synimeve, duke i shfrytëzuar mjetet për realizimin e politikave programore të avancimit të sportit cilësor. Ndërsa sportistët u mbështetën veç e veç sipas shumave në vijim: Majlinda Kelmendi me 15 000 euro, Nora Gjakova me 9 000 euro, Distria Krasniqi me 7 500 euro, Loriana Kuka me 6 750 euro, Akil Gjakova me 6 750 euro, Shpat Zeka me 3 750 euro, Erza Muminoviq me 3 000 euro dhe Laura Fazlia me 1 500 euro.

Sportistët mjetet duhet t'i shfrytëzojnë për aktivitete dhe përgatitje sportive. Me këtë rast, ministri Gashi vlerësoi se kjo përkrahje e MKRS-së për trajnerin Kuka dhe sportistët vjen në bazë të rezultateve që ata kanë treguar dhe që i kanë sjellë vendit tonë medalje dhe kanë ngritur flamurin e Republikës së Kosovës anekënd Botës. "Është një ditë e veçantë edhe për mua si ministër, për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe për vetë shtetin që e kemi një mundësi për të mbështetur edhe financiarisht ata të cilët pothuajse çdo vikend po na bëjnë krenarë me rezultate dhe me medalje të ndryshme që po i sjellin pothuajse në të gjitha garat që po realizohen edhe në Evropë dhe përtej Evropës", ka thënë ministri Gashi.

"Është obligim yni si shtet t'i rrimë karshi një pune të shkëlqyeshme që po e bën trajneri bashkë me sportistët dhe për mua si ministër dhe për Qeverinë e Republikës së Kosovës është nder dhe kënaqësi që t'i mbështesim në vazhdimësi ata të cilët po e mbrojnë më së miri flamurin e Kosovës dhe në të njëjtën kohë po e promovojnë shtetin e ri të Kosovës në të gjitha garat nëpër botë", ka deklaruar Gashi.

Ministri Gashi foli edhe për sukseset e sportistëve të pranishëm, e veçanërisht të Majlinda Kelmendit. "Ndihem shumë i lumtur që kemi pasur një rikthim shumë të fuqishëm të Majlindës në ngjarjet e fundit sportive dhe besoj se me këtë trend të cilin Majlinda e ka nisur do të përfundojë edhe në Lojërat Olimpike 'Tokyo 2020' për të cilat edhe si shtet, por edhe si klub i xhudos, jemi të fokusuar të dalim sa më mirë", ka shtuar Gashi.

Në këtë ceremoni ministri foli edhe për ndërtimin e objektit të sportit të xhudos duke thënë se është jashtëzakonisht i pakënaqur me veprimet e Komunës së Pejës e cila ende nuk e ka përcaktuar vendin për ndërtimin e objektit. "I bëj thirrje kryetarit të Komunës së Pejës dhe strukturave komunale që përfundimisht ta përcaktojnë lokacionin për ndërtimin e objektit të xhudos sepse Ministria e Sportit i ka mjetet e ndara dhe është shumë e interesuar që sa më shpejt ta fillojmë ndërtimin e këtij objekti për përgatitje, në të njëjtën kohë për organizimin e garave të ndryshme. Ministria dhe unë si ministër do të jemi në mbështetje tuajën të vazhdueshme sepse ju jeni krenaria e sportit, krenaria e Pejës, e Kosovës dhe e të gjithë shqiptarëve anembanë", ka shtuar ministri Gashi.

Ndërkaq trajneri Kuka u shpreh shumë i kënaqur dhe falënderues për nënshkrimin e këtyre memorandumeve dhe fillimisht e përgëzoi ministrin për punën e tij për sportin dhe sportistët, e "sidomos për finalizimin e kategorizimit të sportit, sportistëve dhe trajnerëve, duke theksuar e keni kthyer dinjitetin te sportistët të cilët me të vërtetë po na bëjnë krenarë". "Në emër të Federatës së Xhudos, sidomos në emër të këtij komuniteti sportiv dhe të këtyre sportistëve elitarë, jam falënderues ndaj punës suaj dhe këtë po e them si rrjedhshmëri e një bashkëbisedimi tonë. Këtu janë tetë sportistë që i kanë prekur medaljet e kampionateve evropiane, botërore e të Lojërave Olimpike të rritur me një ambient shumë të vogël, duke shpresuar gjithmonë që Qendra Nacionale do t'i mbledhë fëmijët e të gjitha trevave shqiptare", ka deklaruar Kuka.

Ai, po ashtu, përmendi neglizhimin e Komunës së Pejës për përcaktimin e vendit për ndërtimin e objektit të xhudos duke thënë se, pavarësisht kësaj, po vazhdojnë të punojnë dhe të përgatiten për Lojëra Olimpike. "Sot për sot i kemi pesë norma olimpike. I gjithë sporti i Kosovës ka zero normë e komuniteti i xhudos i ka pesë norma olimpike për Tokyo. Kjo duhet të potencohet gjithmonë në mënyrë që edhe veprimet e ministrit të arsyetohen gjithmonë", përfundoi trajneri Kuka.

Ndërkaq në emër të sportistëve foli xhudistja Majlinda Kelmendi e cila fillimisht falënderoi ministrin për punën e tij për sportistët dhe sportin në përgjithësi. "Unë dhe të gjithë sportistët që janë këtu ndihemi më të sigurt dhe më të qetë kur e dimë që e kemi përkrahjen e shtetit dhe që shteti është pas nesh në çdo rrugëtim tonin. Ju japim fjalën që do të vazhdojmë të punojmë, t'ju bëjmë krenarë juve dhe të gjithë shqiptarët kudo që janë", ka thënë Kelmendi.

SHKURT

Valverde: Edhe të shtunën do të luajmë për fitore

Trajneri i Barcelonës, Ernesto Valverde, kërkon që ekipi i tij të përmirësohet më shumë në repartin e avancuar. Ai e pranoi që Reali bëri një ndeshje mjaft të mirë, por katalanasit korrigjuan gabimet në pjesën e dytë. "U luajtën dy pjesë loje shumë të ndryshme nga njëra-tjetra. Ata ishin më mirë në pjesën e parë. Na bënin shumë presion dhe na morën shumë topa me ritmin e shpejtë të lojës. Pastaj me fillimin e pjesës së dytë ishim më këmbëngulës. Ata nuk shënuan dot në 45 minuta, ndërsa ne po. Mendoj se duhet të përmirësohemi më shumë. Të shtunën është edhe më vështirë", ka thënë Valverde. I pyetur për paraqitjen e Luis Suarezit, Valverde është përgjigjur: "Në tërësi ai shënon gola dhe kjo është diçka e mirë. Nuk do të ketë shumë lojtarë që në këtë sezon do t'i shënojnë dy 'hat-tricke' skuadrës së Realit. Të shtunën? Është tjetër histori në kampionat. Do të luajmë për fitore, por sigurisht se duhet të përmirësohemi", ka shtuar trajneri i Barcelonës.

Solari: Çuditërisht nuk shfrytëzuam asnjë rast

Santiago Solari është shumë i zhgënjyer për eliminimin nga Kupa dhe thotë se skuadra e tij nuk e meritonte. Trajneri i Realit pranon që ekipi bëri një ndeshje mjaft të mirë, por në futboll kanë vlerë golat. "Do të shkojmë të mërzitur në shtëpi. Në futboll vlejnë golat dhe ne nuk shënuam dot. Rivalët ishin të fortë në këtë aspekt. Ne kishim rastet e duhura për të shënuar dhe për të shkuar në finale. Më vjen çudi që asnjërin prej këtyre rasteve nuk e dërguam në rrjetë. Jemi në rrugën e duhur për t'u rikthyer dhe për të luajtur me rregull, origjinalitet dhe krijueshmëri. Goli? Duhet të përmirësohemi dhe ta korrigjojmë këtë situatë që në ndeshjen e radhës", ka thënë Solari. Trajneri i Realit u thuri elozhe dy futbollistëve Regilon dhe Vinicius, por nuk preferoi të fliste për "El Clasicon" e së shtunës. "Tani do të pushojmë pak dhe pastaj do të flasim për ndeshjen e ardhshme ndaj Barcelonës. Më të mirët? Vinicius dhe Regilon më pëlqyen. Ishin të jashtëzakonshëm. Por janë lojtarë të rinj dhe kanë mundësi për t'u përmirësuar", ka shtuar Solari.

Mourinho sezonin tjetër rikthehet te Reali

Ish-presidenti i Realit, Ramon Calderon, ka trazuar ujërat nëpërmjet një postimi në "Twitter" për sa i takon trajnerit të ri të madrilenëve. "Kam një ndjenjë, dhe diçka më shumë, se sezonin e ardhshëm Mourinho do të ulet në stolin e Real Madridit", ka shkruar Calderon.

Edhe pse portugezi në deklaratat e fundit ka lënë të hapur një rikthim të mundshëm tek Interi, nuk është çudi që Florentino Perez ta joshë Mourinhon për të ndryshuar destinacion dhe për t'u rikthyer në Madrid.

Roma kompleton transferimin e Cristantes

Roma ka arritur ta kompletojë transferimin e Bryan Cristante nga Atalantas. Skuadra italiane ka njoftuar se e ka mbyllur marrëveshjen për transferimin e lojtarit që ishte i huazuar nga rivali i tyre në ligë. "Kushtet për kontratën e re janë arritur", ka shkruar Roma në faqen e vet zyrtare. Skuadra italiane kishte paguar pesë milionë euro për huazimin e tij, ndërsa e ka kompletuar transferimin permanent për 15 milionë të tjerë. Cristante do të qëndrojë te Roma deri në vitin 2024, gjersa do të fitojë 1.4 milion euro në sezon.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
KOMUNA E PRIZRENIT
Kryetari i Komunës
Nr. 01- 20/19
Datë: 22.02.2019

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

01 Nr. 20/19 Dt. 22.02.2019

Në bazë të nenit 8 parag. 5 dhe nenit 4 parag. 2, nën paragrafi 2.4.3. pika 2.4.3.1. të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-205 të dt: 28.10.2010, Organi Shpronësues-Kryetari i Komunës së Prizrenit pas shqyrtimit të Kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike të dt: 08.02.2019, me qëllim të realizimit të Projektit për "Ndërtimin e rrugës në Lagjen Gurishta", nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 të dt: 20.02.2010, dhe nenit 44 të LPPA-së nr.05/L-031 të dt:25.05.2016, merr këtë :

V E N D I M

I. **PRANOHET** si qëllim i ligjshëm publik dhe e bazuar kërkesa për shpronësimin e pronave të paluajtshme në parcelat kadastrale në pjesët e të cilave duhet të realizohet projekti për "Ndërtimin e rrugës në Lagjen Gurishta", me të dhënat e përshkruara sipas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike të dt: 08.02.2019.

II. Kërkesa për shpronësim në fjalë do të shqyrtohet në procedurë të mëtejme me qëllim të Realizimit të projektit për "Ndërtimin e rrugës në Lagjen Gurishta" për ZK Prizren.

A r s y e t i m

Drejtoria e Shërbimeve Publike me kërkesën e vet më dt: 08.02.2019, ka kërkuar shpronësimin e pronave të paluajtshme të cekura si në Kërkesën e datës së të cekur më lartë, të cilat gjenden në ZK Prizren sipas fletëve poseduese me të dhënat e përshkruara më afër në kërkesën për shpronësimin nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Subjekti kërkues me rastin e paraqitjes të kësaj kërkese, të njëjtës ia ka bashkangjitur të gjitha dokumentet e nevojshme që parashihen në dispozitën e nenit 8. paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, me nr. 03/L-205 të dt: 28.10.2010 të Republikës së Kosovës dhe atë:

- kërkesën për shpronësim,
- kopjet e listave poseduese dhe kopjet e planit për parcelat e shpronësuara,
- projektin për realizimin e ndërtimit të rrugës në Lagjen Gurishta dhe
- dokumentin për disponueshmërin e mjeteve financiare.

Organi shpronësues – Kryetari i Komunës ka pranuar kërkesën në fjalë të Drejtorisë për Shërbime Publike për shpronësimin e parcelave kadastrale me të dhënat e përshkruara si në kërkesë, ku kësaj kërkese i është bashkangjitur edhe dokumenti përmes të cilit dëshmohet se Komuna e Prizrenit ka siguruar mjete të mjaftueshme financiare për pagimin me kohë të kompensimit në emër të shpronësimit të pjesëve të pronave të paluajtshme sa i përket realizimit të projektit.

Duke qenë se kërkesa në fjalë është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi dhe në pajtim me nenin 8 paragr. 5 lidhur me nenin 4. të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr. 03/L-205 të Republikës së Kosovës.

Me këtë Vendim njoftohet:
Subjekti kërkues
Arkivi
Pala

Organi Shpronësues:
Kryetari i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
PRİZREN BELEDİYESİ
Belediye Başkanı
No. 01- 20/19
Tarih: 22.02.2019

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

01 Nr. 20/19 Dt. 22.02.2019

28.10.2010 tarihli ve 03/L-205 sayılı Gayrimenkul Mülkiyetin Kamulaştırılması ile ilgili 03/L-139 sayılı Yasanın Değiştirilmesi ve Tamamlanması için 8. Maddesi, 5. Fıkrası, 4. Maddesi, 2. Fıkrası, 2.4.3 altfıkrası gereğince Kamulaştırma Organı – Prizren Belediye Başkanı, " Gurishta semtinde yol inşaatı" projesinin gerçekleştirilmesi amacıyla 08.02.2019 tarihli Kamu Hüzmetler Müdürlüğünün talebini görüşmesi ardından 20.02.2010 tarihli ve 03/L-040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un 13. Maddesi, 25.05.2016 tarihli ve 05/L-031 sayılı GİPY 44. Maddesi doğrultusunda aşağıda yer alan kararı alır:

KARAR

I. 08.02.2019 tarihli Kamu Hizmetler Müdürlüğün talebi doğrultusunda ifade edilen verilerle " Gurishta semtinde yol inşaatı" projesinin gerçekleştirilmesi gereken kısımların kadastro parsellerinde gayrimenkul mülkiyetlerin kamulaştırılması için talep meşru bir kamu amacı ve esaslı olarak **KABUL EDİLMEKTEDİR.**

II. Söz konusu kamulaştırma talebi Prizren KB " Gurishta semtinde yol inşaatı" projesinin gerçekleştirilmesi amacıyla sonraki süreçlerde incelenecektir.

Açıklama

Kamu Hizmetler Müdürlüğü 08.02.2019 tarihli talebi doğrultusunda, Kamu Hizmetler Müdürlüğünce kamulaştırla talebinde belirtilen verilerle sahiptlik belgere istinaden Prizren KB bulunan ve yukarıda belirtilen tarihteki talepte belirtilen gayrimenkul mülkiyetlerin kamulaştırılmasını talep etmiştir.

Talepte bulunan makam işbu talebi sunması üzerine aynısına Kosova Cumhuriyetin 28.10.2010 tarihli ve 03/L-205 sayılı gayrimenkul mülkiyetin kamulaştırılması ile ilgili 03/L-139 sayılı yasanın değiştirilmesi ve tamamlanması için 8. Maddenin, 2 ve 3. Fıkrasının hükümlerinde öngörülen gerekli tü belgeleri ve aşağıda yer alanları eklemiştir:

- Kamulaştırla talebini,
- Sahiplik listelerin kopyalarını ve kamulaştırılan parseller için plan kopyalarını,
- Gurishta semtinde yol inşaatın gerçekleştirilmesi projesini ve
- Finansal kaynakların mevcudiyeti hakkında belgeyi.

Kamulaştırma Organı – Belediye Başkanı talepte belirtilen verilerle kadastro parsellerin kamulaştırılması ile ilgili Kamu Hizmetler Müdürlüğün talebini kabul etmiştir ki söz konusu talebe projenin gerçekleştirilmesi ile ilgili olan gayrimenkul mülkiyet kısımınların kamulaştırılması adına telatinin zamanında öndenmesi için Prizren Belediyesinin gerekli olan finansal kaynakları sağladığını kanıtlayan belge de eklenmiştir.

Sözü edilen talep esaslı olduğu için ve Kosova Cumhuriyetin 03/L-205 sayılı gayrimenkul mülkiyetin kamulaştırılması ile ilgili 03/L-139 sayılı yasanın değiştirilmesi ve tamamlanması için yasanın 4. Maddesi ile bağlantılı olarak 8. Maddesi, 5. Fıkrası uygun olarak işbu kararın hükmüne karar verildi.

İşbu karar ile aşağıda yer alanlar bilgilendirilmelidir:
Talep eden makam
Arşiv
Taraf

Kamulaştırma Organı:
Belediye Başkanı

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
OPŠTINA PRIZREN
Predsednik Opštine
Br. 01- 20/19
Dana: 22.02.2019

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

01 Nr. 20/19 Dt. 22.02.2019

Na osnovu člana 8 parag. 5 i člana 4 parag. 2, podparagraf 2.4.3. tačka 2.4.3.1. Zakona o Izmenama i Dopunama Zakona Br. 03/L-139 za Eksproprijaciju Nepokretne Imovine Br.03/L-205 od dana 28.10.2010, Organ Eksproprijacije – Predsednik Opštine Prizren nakon razmatranja zahteva Direktorijata za Javne Usluge od dana 08.02.2019, u cilju realizacije Projekta za "Izgradnju puta u naselju Gurišta", člana 13 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br. 03/L-040 od dana 20.02.2010 i člana 44 ZUPA Br.05/L-031 od dana 25.05.2016, donosi ovu:

O D L U K U

I. **PRIHVATA SE** kao zakonski javni cilj i osnovan zahtev za eksproprijaciju nepokretnih imovina u katastarskim parcelama, na delovima gde treba da se realizuje projekat za "Izgradnju puta u naselju Gurishta", sa opisanim podacima prema zahtevu Direktorijata za Javne Usluge, od dana 08.02.2019.

II. Zahtev za navedenu eksproprijaciju razmatraće se u daljnjoj proceduri u cilju realizacije projekta za "Izgradnju puta u naselju Gurišta" za KZ Prizren.

O b r a z l o ž e n j e

Direktorijat za Javne Usluge svojim zahtevom od dana 08.02.2019, tražio je eksproprijaciju nepokretnih imovina, navedenih kao u zahtevu gore navedenog datuma, koje se nalaze u KZ Prizren, prema posedovnim listama sa bliže opisanim podacima u zahtevu za eksproprijaciju od strane Direktorijata za Javne Usluge.

Podnosioc zahteva prilikom podnošenja ovog zahteva, istom je priložio sva potrebna dokumenta koja se predvidjaju u odredbi člana 8. paragraf 2 i 3 Zakona o Izmenama i Dopunama Br 03/L-139 za Eksproprijaciju Nepokretne Imovine Br. 03/L-205 od dana 28.10.2010 Republike Kosova, i to:

- Zahtev za eksproprijaciju,
- Kopije posedovnih lista i kopije plana za eksproprijisane parcele,
- Projekat za realizaciju izgradnje puta u naselju Gurišta, i
- Dokumenat o raspolaganju finansijskih sredstava.

Organ eksproprijacije – Predsednik Opštine primio je navedeni zahtev Direktorijata za Javne Usluge za eksproprijaciju katastarskih parcela sa opisanim podacima kao u zahtevu, gde je ovom zahtevu priložen i dokumenat kojim se dokazuje da je Opština Prizren obezbedila potrebna finansijska sredstva za blagovremeno isplačivanje nadoknade na ime eksproprijacije delova nepokretnih imovina, što se tiće realizacije projekta.

Pošto je navedeni zahtev osnovan, odlučeno je kao u dispozitivu ove Odluke i u skladu sa članom 8 paragraf 5 vezano sa članom 4 Zakona o Izmenama i Dopunama Zakona Br 03/L-139 za Eksproprijaciju Nepokretne Imovine Br. 03/L-205 Republike Kosova.

Ovom Odlukom upoznati:
Podnosioca zahteva
Arhivu
Stranku

Organ Eksproprijacije:
Predsednik Opštine
Prof. Dr. Myzafer Haskuka



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Agjencia Kosovare e Privatizimit është e ngarkuar për të privatizuar Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë përmes metodës së spin-off-it dhe likuidimit. Investitorët ftohen t'i blejnë përmes tenderit të hapur dhe konkurrues asetet e disa NSH-ve në likuidim të radhitura më poshtë.

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
SHPALL SHITJEN E 45-të TË ASETEVE TË NDËRMARRJEVE NË LIKUIDIM

Subjektet / njësitë e përcaktuara më poshtë janë nën juridiksionin e AKP-së në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-034 për Privatizim mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ofertat e mbyllura për njësitë në vijim duhet të dorëzohen në "**Sallën e konferencave - Hotel Grand" në Prishtinë**, më **03 prill 2019,** ndërmjet orës **10:00 dhe 12:00** (sipas kohës lokale të Evropës Qendrore), dhe të shoqëruara nga depozita e ofertës dhe tarifa për paraqitjen e ofertës, siç është parashikuar për secilin artikull. Të gjitha ofertat duhet të paraqiten në përputhje me Rregullat e Tenderit të zbatueshme për shitjet me likuidim. Të gjitha njësitë e radhitura këtu ofrohen për shitje mbi bazën "siç është" dhe "ku është" dhe do të shiten në përputhje me termet ligjore dhe kushtet e shitjes. Veçanërisht dhe pa ndryshuar kushtet e tilla, AKP nuk jep garanci, qoftë të shprehur apo të nënkuptuar, sa i përket gjendjes apo përshkrimit të njësive që shiten ose përshtatshmërisë së tyre për ndonjë përdorim apo qëllim. Verifikimi i përshkrimit dhe gjendjes së të gjithë njësive të listuara këtu është përgjegjësi e ofertuesit.

Njësia nr.01: Pasuria Bujqësore Toka në Bablak (Lot B) - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 853m² (8ari 53m²), në ZK dhe në afërsi të fshatit Bablak Komuna e Ferizajt, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 1,000)**

Njësia nr.02: Pasuria Bujqësore Toka në Papaz (Lot D) - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 1237m² (12ari 37m²), në ZK dhe në afërsi të fshatit Papaz Komuna e Ferizajt, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 2,000)**

Njësia nr.03: Pasuria Bujqësore Toka në Sojevë (Lot C) - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 32402m² (3ha 24ari 02m²), në ZK dhe në afërsi të fshatit Sojevë Komuna e Ferizajt, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 12,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:
N.Sh „Pasuria Bujqësore" Ferizaj Fi-650/89

Njësia nr.04: KB Prekoci Objektet në Prekoc - ofron për shitje objektet me sipërfaqe të përgjithshme prej 560m², në ZK dhe në afërsi të fshatit Prekoc Komuna e Novobërdës, të cilat janë të përshtatshme për veprimtari bujqësore.
(Depozita e ofertës: € 3,000)
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:
KB „Prekovci" Novobërdë Fi-1612/90

Njësia nr.05: Agromorava Toka në Kabash (Lot A) – ofron për shitje tokën bujqësore në sipërfaqe të përgjithshme prej 8639m² (86ari 39m²), në ZK dhe në afërsi të fshatit Kabash, në Komunë të Vitisë. Lokacioni është i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme afariste/bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 5,000)**

Njësia nr.06: Agromorava Toka në Sllatinë të Epërme (Lot B) – ofron për shitje tokën bujqësore në sipërfaqe të përgjithshme prej 32909m² (3ha 29ari 09m²), në ZK dhe në afërsi të fshatit Sllatinë e Epërme në Komunën e Vitisë. Lokacioni është i përshtatshëm për zhvillimin aktiviteteve të ndryshme afariste/bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 10,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:
P.I.P.P.Agromorava Fi-229/89

Njësia nr.07: Pasuria Bujqësore Toka në Prelez të Jerlive (Lot B) - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 8781m² (87ari 81m²), në ZK dhe në afërsi të fshatit Prelez i Jerlive në Komuna e Ferizajt, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 5,000)**

Njësia nr.08: Pasuria Bujqësore Toka në Pojatë (Lot C) - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 17351m² (1ha 73ari 51m²), në ZK dhe në afërsi të fshatit Pojatë në Komuna e Ferizajt, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 10,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:
N.Sh „Pasuria Bujqësore" Ferizaj Fi-650/89

Njësia nr.09: Agrokultura Toka në Velekincë (Lot A) - ofron për shitje tokën në sipërfaqe prej 6459m² (64ari 59m²), në ZK dhe në afërsi të fshatit Velekincë, Komunë të Gjilanit, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore.
(Depozita e ofertës: € 6,000)
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:
NSH IKB "MLADOST" Fi - 670/89, KB Gjilan, OP "Mladost" Fi -106 /78, JUKO-MLADOST SHA PP Fi - 1865/96.

Njësia nr.10: Agromorava Toka në Pozharan (Lot F) – ofron për shitje tokën bujqësore në sipërfaqe të përgjithshme prej 29356m² (2ha 93ari 56m²), në ZK dhe në afërsi të fshatit Pozharan në Komunën e Vitisë. Lokacioni është i përshtatshëm për zhvillimin aktiviteteve të ndryshme afariste/bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 8,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:
P.I.P.P.Agromorava Fi-229/89

Njësia nr.11: Qëndresa Lokali 5 në Kamenicë - ofron për shitje lokalin me sipërfaqe të përgjithshme prej 260m². Lokali gjendet në katin përdhesë të një ndërtese kolektive përballë Qerdhës së Fëmijëve në Kamenicë, i cili është i përshtatshëm për veprimtari tregtare. **(Depozita e ofertës: € 16,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:
NSHT "Morava" Kamenicë (Fi-711/89)

Njësia nr.12: Morava e Binçës Toka në Gllamë – ofron për shitje tokën në sipërfaqe prej 24951m² (2ha 49ari 51m²). Prona gjendet në periferi të qytetit të Gjilanit, në afërsi të fshatit Stanishor, në Komunë të Gjilanit dhe Novobërdës. Lokacioni është i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme afariste. **(Depozita e ofertës: € 70,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:
HGIP Binacka Morava (Fi-307/89); N.Sh. DD "Binacka Morava" (Fi -6270/92),

Njësia nr.13: Agromorava Toka në Viti (Lot B) - ofron për shitje tokën me sipërfaqe të përgjithshme prej 2561m² (25ari 61m²), në ZK dhe Komunën e Vitisë, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore.
(Depozita e ofertës: € 7,000)
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:N.B.I.Q "Agromorava" Vitina (Fi-229/89)

Njësia nr.14: Agrokultura Toka në Malishevë (Lot C) - ofron për shitje tokën bujqësore në sipërfaqe përgjithshme prej 24334m² (2ha 43ari 34m²), në ZK dhe në afërsi të fshatit Malishevë të Komunës së Gjilanit, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 15,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:
NSH IKB "MLADOST" Fi - 670/89, KB Gjilan, OP "Mladost" Fi -106 /78, JUKO-MLADOST SHA PP Fi - 1865/96.

Njësia nr.15: Elan Toka në Dumnicë e Llugës - Kjo shitje ofron tokën bujqësore me sipërfaqe 66933m² (6ha 69ari 33m²), në ZK Dumnicë e Llugës, Komuna e Vushtrrisë. **(Depozita e ofertës: € 15,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:
NSHB Elan - Vushtrri Fi-791/89; JSC Ratar Fi-7899/92; N.SH.B. Elan UNMIK Regj.nr. 80025629

Njësia nr.16: LUX Lokali Dëshira e Juaj I - Kjo shitje ofron lokalin afarist me sipërfaqe prej 100.57m² e përcaktuar sipas matjeve në terren, ndërsa sipas listës së aseteve, sipërfaqja është 80m². Lokali gjendet në rrugën "Xhafer Deva" në Mitrovicë. Prona është e lëshuar me qira. **(Depozita e ofertës: € 10,000)**

Njësia nr.17: LUX Lokali Dëshira e Juaj II - Kjo shitje ofron lokalin afarist me sipërfaqe prej 52m² sipas listës së aseteve, ndërsa sipas matjeve në terren sipërfaqja është 50.30m². Lokali gjendet në rrugën "Xhafer Deva" në Mitrovicë. Prona është e lëshuar me qira. **(Depozita e ofertës: € 5,000)**

Njësia nr.18: LUX Lokali Kristal - Kjo shitje ofron lokalin afarist me sipërfaqe prej 65.74m² e përcaktuar sipas matjeve në terren, ndërsa sipas listës së aseteve, sipërfaqja është 50m². Lokali gjendet në rrugën "Xhafer Deva" në Mitrovicë. Prona është e lirë, e demoluar pjesërishtë. **(Depozita e ofertës: € 6,000)**

Njësia nr.19: LUX Lokali Napred - Kjo shitje ofron lokalin afarist me sipërfaqe prej 51m² sipas listës së aseteve, ndërsa sipas matjeve në terren sipërfaqja është 49.73m². Lokali gjendet në rrugën "Xhafer Deva" në Mitrovicë. Prona është e lëshuar me qira. **(Depozita e ofertës: € 5,000)**

Njësia nr.20: LUX Lokali Shija I - Kjo shitje ofron lokalin afarist me sipërfaqe prej 77.76m² e përcaktuar sipas matjeve në terren, ndërsa në listën e aseteve, nuk paraqitet me sipërfaqe. Lokali gjendet në rrugën "Xhafer Deva" në Mitrovicë. Prona është e lëshuar me qira. **(Depozita e ofertës: € 8,000)**

Njësia nr.21: LUX Lokali Shija II - Kjo shitje ofron lokalin afarist me sipërfaqe prej 22.10m² e përcaktuar sipas matjeve në terren, ndërsa në listën e aseteve, nuk paraqitet me sipërfaqe. Lokali gjendet në rrugën "Xhafer Deva" në Mitrovicë. Prona është e lirë. **(Depozita e ofertës: € 3,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: N.Sh. "Lux" Fi - 200/89; Fi- 6273/92; UNMIK regj.nr. 80038216

Njësia nr.22: NSHBQ Drenica Toka në Gllanaselë nr.2 - Kjo shitje ofron tokën bujqësore me sipërfaqe prej 24731m² (2ha 47ari 31m²), në ZK Gllanaselë, Komuna e Gllogocit. **(Depozita e ofertës: € 8,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat:
